



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 07 mars 2017, në mbledhjen e XXXIX-të (tridhjetenëntë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht seancën e hapi duke përshëndetur të pranishmit dhe duke konstatuar prezencën e këshilltarëve të Kuvendit, në vazhdim i uroi 7 marsin Ditën e Mësuesit, këshilltarëve të Kuvendit të cilët njëkohësisht janë mësimdhënës dhe të gjithë mësimdhënësve për punën e tyre të shenjtë dhe të palodhshme në arsim për edukimin e brezave të rinj. Në vazhdim Kryesuesi i njoftoj edhe për deklaratimet e pasurisë që duhet të bëhen nga këshilltarët e Kuvendit ku afati është deri më 31 mars 2017. Në vazhdim Kryesuesi shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialin e propozuar të ditës e keni marr me kohë, po ashtu rekomandimet nga mbledhja e KPF-së mbajtur dje më 06.03.2017 ju janë shpërndarë në hyrje të kësaj mbledhjeje, dhe me siguri keni vërejt se njëzëri nga anëtarët e KPF-së i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim këto pika dhe rendi i ditës në përgjithësi. Në këtë muaj kemi paraparë ta mbajmë edhe një mbledhje ku në rend dite do të jetë raporti financiar për vitin 2016 dhe propozim Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunal, e hapi diskutimin.

z. Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e fundit të Kuvendit e cila është mbajtur më 02.02.2017, unë në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kam propozuar që të sjellët një informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me gjendjen e pyjeve. Në zyrën tonë kemi pas shumë kërkesa nga qytetarët lidhur me dëmtimin e pyjeve dhe ato kërkesa dhe ankesa unë i kam paraqitur. Në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhje e cekur është diskutimi i Kryesuesit të Kuvendit, në faqe 4 ku ndër të tjera thotë, *unë jam për një informatë të tillë, por për këtë mbledhje nuk kemi material për të diskutuar*. Sot kemi mbledhjen tjetër dhe mendoj se gjithsesi është dashur ta kemi një material, por nuk duhet të thuhet, mendoj se kjo çështje nuk është urgjente. Tani kjo çështje bie në kundërshtim me planin e KKS-së dhe informatën e cila na është dhënë dje në mbledhjen e KPF-së lidhur me planin e KKS-së. Mendoj se çështja e dëmtimit të pyjeve është shumë urgjente ashtu siç është edhe mbrojtja e tyre madje është çështje kryesore, për të mos thënë më kryesorja. Andaj është mirë që njëherë e

përgjithmonë kërkesat e qytetarëve të merren seriozisht nga Ekzekutivi i Komunës dhe kjo i dedikohet edhe Kryesuesit të Kuvendit i cili me rastin e përgatitjes së rendit të ditës së bashku me Kryetarin e Komunës, e jo të shfrytëzohen vetëm votat, e them këtë sepse kjo tani po bie në kundërshtim me planin e KKSBB-së, bie në kundërshtim edhe me informatën e KKSBB-së, ku në ato kërkohet nga të gjithë që të jemi vigjilent sa i përket mbrojtjes së pyjeve kurse në anë tjetër thuhet se nuk është diçka urgjente. Edhe një herë kërkoj që sot në këtë rend të ditës të futet informata lidhur me gjendjen e pyjeve, sepse kemi dëmtime të pyjeve në të gjitha anët, dhe në këtë aspekt unë shtroj pyetje, a më shumë kemi dëmtime në periudhën 1999 – 2017 apo 1990 – 1999.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, në fakt mu bë qejfi që Kryesuesi e paralajmëroj sjelljen e propozim Rregullores për taksa tarifa dhe gjopa komunale për seancën e radhës, por mendoj se kjo është dashur të bëhet më herët ngase qe 7 vite kemi një Rregullore ku qytetarët plaçkiten dhe ajo plaçkitje është legalizuar me atë Rregullore. Mirëpo unë pyes Kryesuesin e Kuvendit, a ke ndërmend, meqë është viti i katërt që ky Kuvend asnjëherë nuk është marrë me raportin e auditit të brendshëm, pastaj asnjëherë nuk është trajtuar raporti i zyrës së prokurimit, e që në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është obligim i përvjetshëm, gjegjësisht edhe në detyrat dhe obligimet ligjore të të famshmit Komitet për Politik dhe Financa të këtij Kuvendi në mënyrë decrive thuhet që duhet të trajtohen për çdo vit raportet e auditorit të brendshëm dhe raporti i zyrës së prokurimit.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket pyetjes së z.Haki Rudarit, është e vërtetë që ai në mbledhjen e kaluar ka kërkuar një pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës, rreth pylltarisë, dhe unë e kam thënë se nuk mund të diskutojmë për një çështje kur nuk kemi material përkatës, por e kam thënë që mund të diskutojmë për një mbledhje tjetër të radhës, e jo ashtu siç u tha për mbledhjen e radhës. Konsideroj se është gjë e mirë që në planin e punës të Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është paraparë kjo çështje, po ashtu unë kam biseduar me drejtorin e Drejtorisë në fjalë, ku në planin e punës të asaj Drejtorie është edhe raporti për bujqësinë, por më është thënë që njëkohësisht do të përgatitet edhe raporti për pylltari, dhe pasi të shqyrtohen në KKSBB, me siguri se do të sjellën në Kuvendin e Komunës, andaj mendoj se arsyetimi është i qëndrueshëm sepse asnjëherë nuk mund të diskutojmë për çështje të rëndësishme pa pasur material bazë nga Ekzekutivi i Komunës.

Sa i përket pyetjes së z.Lutfi Rexhepi, mua më duket paksa i tepërt ai ofendim, kur u përdor shprehja plaçkitë, sepse kemi të bëjmë me një Rregullore e cila në atë periudhë është miratuar nga Kuvendi i Komunës, por si do që të jetë, unë e thash që do të sjellët propozimi i ri i Rregullores në fjalë. Ndërsa sa i përket pyetjes rreth raportit të auditorit të brendshëm, ne jemi dëshmitar që raporti i auditorit gjeneral është sjellë rregullisht në Kuvend, raport i cili mendoj se është më i besueshëm, mirëpo të gjitha ato pika që janë paraparë me plan të punës së Kuvendit unë do të insistoj gjithherë që të sjellën në Kuvend materiale përkatëse në mënyrë që të diskutohen duke përfshirë edhe pyetjet dhe kërkesat e këshilltarëve të Kuvendit, nëse për një gjë të tillë vendos Kuvendi, unë jam për ata që të përfshihen në rend të ditës.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, më duket se isha i qartë, në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në mënyrë decrive thuhet, Komiteti për Politikë dhe Financa duhet ta trajtoj raportin e auditorit të brendshëm çdo vit, pra nuk e thotë raportin e auditorit gjeneral, pastaj thuhet, Komiteti për Politikë dhe Financa ka për obligim ta trajtoj raportin e zyrës së prokurimit. Komiteti për Politikë dhe Financa duhet t'i jep rekomandimet me shkrim për çdo çështje të cilën e trajton, ndërsa ky Komitet, prej që unë e mbaj mend e ka vetëm një fjali, dhe atë, *i rekomandohet Kuvendit që ta procedoj dhe ta trajtoj këtë pikë të rendit të ditës*. Çështja tjetër, unë jam në dijeni, por më duket se ky Komitet po takohet dhe po regjistrohen vetëm sa për të marr një mëditje, madje fundja me sa unë jam në dijeni nuk

është bërë as kostituimi i atij Komiteti ndonjëherë sepse nuk e di që ai Komitet ka një nënkryetar, e që është obligative ta ketë sepse është me rregullore të punës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë si Kryesues i Kuvendit jam që të shqyrtohen të gjitha kërkesat e këshilltarëve të Kuvendit të cilat janë në harmoni me legjislacionin në fuqi por edhe ato çështje që parashihen me ligje dhe akte nënligjore, dhe kjo të mbetet si kërkesë në të ardhmen, mirëpo sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa unë besoj se deri tani ka kryer një punë shumë të mirë, janë shqyrtuar të gjitha materialet, janë bërë debate të ndryshme, ka pas vërejtje të cilat pothuajse gjithherë janë marrë parasysh, andaj nuk e besoj që ka arsye të jepen vërejtje të tilla siç e bëri parafolësi, të drejtë ka, por ne nuk pajtohemi me atë.

z.Haki Rudari, theksoi, ne në këtë mbledhje kemi ardhur të shqyrtojmë rendin e ditës që na është dërguar. Kryesuesi e tha se informata rreth pylltarisë do të dërgohet në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi e pastaj në Kuvendin e Komunës, unë mendoj se kjo është nënçmim i Kuvendit të Komunës, sepse secili i ka detyrat e ndara, KKSBB ka detyra të ndara, ashtu siç i ka edhe Kuvendi i Komunës. Pra nuk jemi ne këtu vetëm sa për pjesëmarrje ose vetëm sa për mëditje, por mendoj se informatat paraprakisht duhet të sjellën në Kuvend në mënyrë që të diskutohen nga 35 këshilltarët e Kuvendit të cilët kanë marrë votat e qytetarëve, e pastaj të dërgohen në sektorë tjera siç është KKSBB. Sa i përket asaj që parafolësi e tha rreth KPF-së, është e vërtetë që me Rregullore duhet të ketë një nënkryetar të KPF-së, e që tek ne nuk është zgjedhë. Pra i nderuari Kryesues është mirë që njëherë e përgjithmonë të merren parasysh kërkesat e këshilltarëve të Kuvendit, dhe në bashkëpunim me Ekzekutivin të njëjtat të hedhën në votim. Sepse tani jemi para një situatë ku në seancën e kaluar u tha se nuk ka material për këtë çështje, ndërsa tani thuhet njëherë duhet të dërgohet ai material në KKSBB e pastaj të sjellët në Kuvend, dhe vetëm po prolongohen.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kur fola për KKSBB-në, e thash duke marrë parasysh se në atë Këshill janë persona të të gjitha fushave dhe më kompetent për shqyrtimin e një informate të tillë në mënyrë që pastaj në Kuvend të sjellët një informatë më e detajuar nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

E hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit u konstatua se me 22 vota për, 3 vota kundër dhe 10 vota të përmbajtura, u miratua rendi i propozuar i ditës, duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 06 mars 2017

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 02 shkurt 2017

U konstatua se njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 02 shkurt 2017.

3. Propozimi i Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2016 në vitin 2017 dhe destinimi në kategori të caktuara buxhetore

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni një propozim për bartjen e të hyrave vetanake të inkasuara dhe të pashpenzuara në vitin 2016, në vitin 2017 dhe atë në programe të caktuara buxhetore sipas projekteve dhe kategorive të caktuara ekonomike, shumë e cila është 781,565.69 €, dhe si e tillë është propozuar të bartet në vitin 2017 dhe në programet si vijon; Administratë komunale, duke përfshirë Drejtorinë përkatëse në shumë 550,290.88 € përveç, Drejtorisë së Arsimit në shumë 215,636.31 €, dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në shumë 15,638.50 €. Shuma e bartjes destinohet në programe dhe kategori të caktuara buxhetore sipas specifikacionit që është pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim përkatësisht bartjen e të hyrave nga viti 2016 në vitin 2017. Këto mjete barten në kode të njëjta në të cilat kanë qenë, mirëpo vetëm barten nga viti 2016 në vitin 2017 në projekte për të cilat ne konsiderojmë se janë shumë të rëndësishme, andaj si të tilla ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim një bartje të tillë. Çështjet tjera me rëndësi mendoj që i sqaroj shumë mirë drejtori parafolës në fjalën hyrëse të tij.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket bartjes së mjeteve të pashpenzuara në vitin 2016, edhe pse drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR) na njoftoj në mbledhjen e KPF-së që për një vit nuk ka mundur t'i shpenzoj mjetet financiare përkatësisht nuk ka mundur të përzgjedh një kompani për furnizim me fidanë të mjedrës, viti 2016 konsideroj ka shkuar zero investim për fermerët, parimisht e them që shuma prej 179,000.00 € të bartet në vitin pasues, edhe pse me ligj lejohet, madje mund të grumbullohen edhe në këtë vit dhe pastaj të barten në vitin 2018 sepse janë të hyra vetanake dhe nuk kemi kurrfarë pengesash, mirëpo kjo nuk është çështje e efikasitetit dhe profesionalizmit të një Drejtorie sa i përket kryerjes së punëve. Gjithherë në këtë Kuvend kemi menduar dhe jemi munduar të ndërtojmë një sistem demokratik ku vota e shumicës të jetë ajo e cila e determinon vendimin, po ashtu po e shohim se nganjëherë po duhet të dalim edhe përtej ambicieve subjektive qoftë individuale qoftë të subjektit politik që i takojmë, në mënyrë që të mbështetim propozime të ndryshme të cilat janë në interes të qytetarëve. I ndërtuari Kryesues, mendoj që edhe pse drejtori në fjalë e thotë se nuk kemi mundur për një vit të tërë të përzgjedhim një kompani fituese për ta kryer atë punë, para fermerëve nuk besoj se do të mund ta arsyetoj këtë sepse jam shumë i bindur që ajo punë do të ishte kryer po të kishte interesim më të madh. Nuk dëshiroj të diskutoj për humbjet e qytetarëve – fermerëve, të cilët merren me atë fushë, si pasoj e jo efikasitetit të një drejtori i cili ndoshta i ka kaluar përmasat e diskutimit sa i përket mos kryerjes së detyrave. Meqë kjo shumë e mjeteve duhet të shpërndahet gjithsesi në këtë vit për fermerët të cilët merren me mjedra, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, kërkoj që të ndërpritet subvencionimi i njerëzve të cilët i shesin të mirat e përfituara për një fushë të caktuar, këtë që e them bazohem në rastet ku ish shoferi i Komunës, apo një person tjetër që jeton në banesë kanë qenë përfitues të makinave mjelëse të cilat kanë kushtuar 350 €, e që pastaj të njëjtat i kanë shitur për 150 €, çështje për të cilën besoj që drejtori i DBPZHR është në dijeni për këtë, andaj do të ishte një banalitet shumë i madh në qoftë se edhe në vitin 2017 ndodh e njëjta gjë. Nuk dëshiroj të përmend emra këtu por nëse në vazhdim të seancës kërkohet nuk e kam problem t'i përmendi, edhe pse mendoj që emrat nuk qojnë ndonjë peshë të madhe në këtë aspekt, por ne po dëshirojmë të ndihmojmë zhvillimin e Komunës edhe

pse nuk jemi pjesë e qeverisjes së kësaj Komune. Po ashtu kërkojmë të mos subvencionohen njerëz të cilët nuk plotësojnë performancën, qoftë me mjedra, qoftë me sistem të ujitjes, qoftë me koshere me bletë, sepse këto subvencione ka raste që shiten pastaj nga ana e përfituesve.

Sa i përket arsimit, në seancën e kaluar kam kërkuar që sistemi arsimorë i mirëfilltë është ai i cili do të edukoj një brez i cili në të ardhmen do të vie në qeverisje, e që shpresoj që brezat e ardhshëm të jenë më serioz. Sa i përket ndërtimit të shkollës në fshatin Llapashticë, ne në vitin e kaluar e kemi ngritur si problem sepse nuk ka pasur kushte për mësim. Në këtë bartje unë vërejtja shumë mbi 6,000 € për rrugën Batllav – Dyz, lidhja nga lagjja Zymeri, sa jam në dijeni Kryetari i Komunës në një seancë të mëparshme na pati njoftuar se kjo rrugë është investim me buxhet të Ministrisë së Infrastrukturës, dhe sa jam sa e di unë ajo rrugë është asfaltuar, dhe këto 6,000 € nuk di për çka janë paraparë, për çfarë pagesa të faturave apo mund të jenë pagesa për ndonjë faturë shumë të mëhershme, ndoshta para 3 viteve, e që unë e di por besoj që edhe drejtori i Drejtorisë përkatëse e din për çka është ajo pagesë.

Ligjërisht kjo bartje është e mundur të bëhet, por janë shuma fikse afër gjysmë milioni euro të cilat duhet të barten nga viti paraprak, pavarësisht kësaj krize që e kemi në Komunën e Podujevës, e që unë mendoj se është qeverisje jo efikase, dhe është fat që këto mjete nuk ka shkuar suficid, dhe është i vetmi fat që ka ky Kuvend dhe qytetarët tanë. Probleme të njëjta besoj se do të paraqiten edhe në vitin 2017, dhe besoj se përgjigje për një gjë të tillë nuk ka as drejtori përkatës, dhe në këtë aspekt ne si këshilltarë të Kuvendit duhet të jemi më kërkues për secilën Drejtori.

Unë nuk mund ta arsyetoj drejtorin e DBPZHR i cili e thotë se brenda një viti nuk kemi mund të gjejmë operator në bazë të ofertave për një kontratë për furnizim, gjë e cila nuk besoj se ka ndodh ende në Komunitat tjera por as në Republikën e Kosovës, madje nuk e besoj se ka qenë vetëm një ofertues. Jam për këtë bartje në këto fusha të cilat i cekëm dhe për mbikëqyrjen e këtyre mjeteve dhe projekteve në mënyrë strikte, qoftë për shkollë, qoftë mjetet për bujqësi, nuk jemi kundër subvencioneve për bujqësi, por jemi kundër që në vitin 2016 nuk ju kanë ndarë asnjë cent atyre fermerëve. Po ashtu mendoj se edhe këshilltarët e LDK-së shumë në mënyrë demokratike nganjëherë duhet të dalin përtej subjektivitetit të tyre politik për çështje të rëndësishme të qytetarëve, për arsye se ata që kërkojnë të jenë sërish në këtë pozitë do të duhet të dalin sërish të kërkojnë besimin e atyre qytetarëve, dhe t’jua japin këtë qeverisje ashtu siç e kanë sot.

z.Haki Rudari, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e kemi analizuar këtë propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017. Mendoj që para se të diskutojmë për këtë, ne si këshilltarë të Kuvendit duke përcjellë edhe punën e Kuvendeve tjera të Komunave të Kosovës, është dashtë t’i kemi; 1-një raport të punës së Kryetarit për vitin 2016, e që është viti i katërt dhe ende neve nuk na është sjellë një raport i tillë, 2-një plan të punës nga Ekzekutivi për vitin 2017, e që po ashtu është viti i katërt që nuk na është sjellë asnjë plan i tillë. Dua të them se paraprakisht është dashur t’i kemi këto që i ceka, mandej t’i dimë të hyrat vetanake në vitin 2016, në mënyrë që pastaj të diskutojmë rreth rialokimit të mjeteve. Sa i përket të hyrave vetanake dhe rialokimit të tyre në shumë 781,565.69 €, mendoj se është një shumë e madhe karshi kërkesave të qytetarëve, unë edhe në mbledhjen e KPF-së e thash se në cilën do lagje ose fshat apo në cilin do sektor kanë mund të harxhohen këto mjete, sepse nevojat për investime janë të mëdha, ndërsa të teprojnë mjete, mendoj se nuk është gjë e mirë dhe mendoj se kjo është si pasoj e një menaxhimi të dobët që bëhet nga Ekzekutivi i Komunës së Podujevës, gjë e cila vazhdimisht përcillet dhe nuk është hera e parë. Kjo është si pasoj e mungesës së projekteve për arsye se Ekzekutivi i Komunës së Podujevës kërcen në projekte, dhe për këtë arsye edhe nuk i specifikon projektet por vetëm thuhet, këtu një, nesër një, pastaj e merr atë e vendos tjetër kund, ku ka interes e merr e qet tjetër kund, Vetëvendosja është kundër këtyre, dhe mendojmë se çdo

herë duhet të kemi specifikim të projekteve për secilën Drejtori, pra kjo është ana negative e Ekzekutivit që po e përcjellë edhe në këtë mandat. Në rast se hyjmë në detaje dhe analizojmë se ku shkojnë këto projekte, duke filluar nga Drejtoria e Planifikimit hapësinor e që unë edhe dje e thash se a ka projekte dhe kode të reja apo janë kthim i borxheve sepse mendoj se këtë duhet ta dimë për arsye se ka shumë qytetarë të cilët kanë bërë projektet madje me vite të tëra, ndërsa kur ne i kemi prezantuar këtu, Ekzekutivi ka thënë se nuk kemi mjete financiare, ndërsa tani kemi tepricë, po që nuk e di ku është faji, dua të them se projektet janë por pse nuk ekzekutohen ato projekte. Sa i përket projekteve tjera nëpër Drejtori, siç është rasti për ndërtimin e zyrës së vendit në fshatin Lluzhan në shumë 30,847.00 €, projekt ky që ndoshta është paksa i vonuar, mirëpo krahas kësaj mendoj se në atë fshat është dashur të bëhen investime edhe më shumë për arsye se është një vend që ka shumë qytetarë dhe lagje të ndryshme.

Megjithatë më vie mirë që një propozim të LVV-së, Ekzekutivi i Komunës e paska marrë, fjala është për propozimin e para rreth dy viteve për ndërtimin e shkollave në fshatrat Bajqinë dhe Llapashticë, dhe tani në vitin 2017 po shihet se është në projekte ndërtimi i shkollës në Llapashticë, por megjithatë edhe pse e kanë ndërlidh me fushat zgjedhore ne i gëzohemi ndërtimit të asaj shkolle sepse është nevojë e kamotshme. Sa i përket Shërbimeve Publike, sërish kemi vetëm shuma por jo edhe vende se ku shkojnë këto projekte, realisht dje në KPF u dhanë disa emra se ku shkojnë këto projekte por është e rëndësishme të jepen për të gjithë këshilltarët, sepse ne ndjehemi keq kur shkojmë nëpër vende të ndryshme, por nuk kemi përgjigje të saktë, ta zëmë, po janë rreth 34,000.00 € për trotuare por nuk jemi në dijeni se për cilët trotuare bëhet fjalë, pra duhet të parashihen me kohë se ku do të realizohen ato projekte, në të kundërtën mund të ketë manipulime sepse njëherë thuhet në një fshat, herën tjetër një fshat tjetër, por nuk qiten me kohë se ku shkojnë ato projekte. Çështje tjetër e cila më bëri përshtypje është edhe meremetimi i rrugëve me zhavorr në shumë 39,000.00 €, dhe për këtë pyes, a dihen se cilat janë ato rrugë apo vetëm parashihet të shpenzohen ato mjete. Po ashtu një vërejtje tjetër që e kemi ne, është edhe në bujqësi, sepse vërejtjet dhe kërkesat e bujqve janë të shumta dhe mendoj se në këtë drejtim qeveria duhet të jetë më serioze në mënyrë që projektet të jenë vërtetë serioze e jo në fund të arsyetohen me mungesë apo sëmundje të ndryshme. Marrë në përgjithësi, kur analizohen këto bartje mendoj se vërtetë del që këto projekte janë si rezultat i menaxhimit të dobët dhe kjo tepricë e mjeteve nga të hyrat janë si rezultat i mungesës së projekteve serioze ngase po të kishim projekte serioze mjetet do të shkonin aty ku janë paraparë ato projekte. Pra unë i gëzohem faktit që këto mjete nuk humbin, por megjithatë do të ishte mirë që ato projekte të parashihen me kohë, dhe në këtë aspekt teprica e mjeteve do të ishte më e ulët.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, vërtetë ne jemi këshilltarë të Kuvendit dhe përfaqësojmë qytetarët e Komunës së Podujevës pa marrë parasysh lokalitetet. Parafolësit, z.Haki Rudarit i them se më vie shumë mirë që Grupi juaj keni parashtruar kërkesë për ndërtimin e shkollës në fshatin Llapashticë, kërkesë e cila është bërë vazhdimisht në kuadër të mundësive, ndërsa tani unë besoj se do të ndërtohet një objekt i mirë i cili do t'i plotësoj kushtet. E vërtetë është që nevoja për një objekt të tillë në atë fshat ka qenë e madhe, mirëpo kërkesa të tilla janë bërë edhe në vitin 2010 dhe 2011, kështu që po i bie që parafolësi z.Haki Rudari nuk ka qenë pjesë e këtij Kuvendi fare kur është parashtruar kërkesa për ndërtimin e shkollës në fshatin Llapashticë.

z.Haki Rudari, theksoi, kur e potencoj parafolësi se kërkesat janë bërë në vitet 2010 dhe 2011, po besoj se po pajtoheni me mua kur e them që vërtetë qeverisja lokale ka mungesa dhe mangësi të shumta, dhe tani është shumë mirë që po gjejmë gjuhë të përbashkët këtu për arsye se faji është i LDK-së, e që tani po pajtoheni edhe ju. Edhe më parë e thash se ajo shkollë po ndërtohet tani në vitin 2017 ku edhe është vit zgjedhor por megjithatë ne i gëzohemi ndërtimit të asaj shkolle,

po të ishte një projekt më serioz, ajo shkollë do të ndërtohej më herët. Zgjedhjet janë afër dhe LVV-ja po udhëheq me regjionin e Prishtinës, e që mendoj se edhe Podujeva është pjesë e saj.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, jo me qëllim të replikës, por mendoj se në vitet 2010 dhe 2011 ka pasur objekte shkollore me një gjendje më të rëndë se objekti i shkollës në fshatin Llapashticë edhe pse ai objekt vërtetë është në gjendje shumë të rëndë, andaj për atë arsye ne kemi shikuar një drejtësi dhe nuk kemi shkuar me logjikën ku dikujt i bie mirë e dikujt jo, pra kemi vendosur ta lëmë në radhë dhe tani i ka ardhur radha, dhe në këtë aspekt besoj se edhe më shumë do të kemi mbështetje nga ana e votuesve.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, ku do të kishim fatin që ne do të kishim nda më shumë buxhet për subvencionim sepse është treguar që nuk duhet të mbështet për një zhvillim në këtë formë, mirëpo mos realizimi i subvencionimeve, që nëse nuk gaboj kanë qenë të ndara rreth 100,000.00 € për mjedra, më duket se është gjëja më e pakuptimtë, sa do që ndokush teknikisht mundohet ta arsyetoj, por fundja unë kujtoj, sepse nga përvojat dhe praktikat e deritanishme, këto forma LDK-ja goxha mirë i ka shfrytëzuar edhe në të kaluarën, por meqë në këtë vit jemi në vit zgjedhor sigurisht që ato mjete janë bartur me qëllim që t'ju ndahen më shumë njerëzve për të marrë vota më shumë, por do të ishte mirë që votat të sigurohen gjatë katër viteve e jo vetëm në vitin e fundit.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kërkoj të bëhet stimulimi i lehonave me nga 100.00 €. Dihet se ne si Grup kemi kërkuar që tri vite radhazi qysh më datën 10 prill 2014, dhe rregullisht kemi përcjellë të dhënat statistikore të maternitetit të Komunës së Podujevës ku në vitin 2014 kanë qenë 74 lindje, në vitin 2015 ka qenë 67 lindje dhe në vitin e kaluar 2016 kanë qenë 50 lindje, andaj sipas këtyre statistikave nuk do të ishte ndonjë shumë e papërballueshme për ta realizuar këtë çështje, si dhe duke u bazuar edhe nga mbetjet e subvencioneve në shumë rreth 189,000.00 € besoj se me një menaxhim të mirë nga Ekzekutivi do të mund të realizohet kjo çështje.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), theksoi, gjatë diskutimeve nga parafolesit u paraqiten disa çështje të cilat i përkasin fushës së bujqësisë, për të cilat po filloj të jap sqarime apo përgjigje. Nga z.Rafet Llapashtica u tha që drejtori nuk ka mundur të përzgjedhë përfituesin për furnizim me mjedra, unë dëshiroj t'ju tregoj që drejtori nuk është ai i cili e përzgjedh përfituesin, por drejtori paraqet kërkesë të cilën e kemi bërë dy herë radhazi, dhe ka aplikuar vetëm një kompani e cila nuk i ka plotësuar kushtet, ndërsa ne nuk kemi qenë të interesuar që çështjen e subvencionimit me mjedra ta shndërrojmë në një mos sukses, por kemi dashtë ta lëmë të suksesshme ashtu siç është tani, dhe siç ka qenë në vitet paraprake. Po ashtu u potencua se kanë qenë zero investime, për mendimin tim të thuhet një gjë e tillë është jo serioze sepse në vitin 2016 kanë qenë përfitues 46 fermerë me sistem të ujitjes në një sipërfaqe të tërësishme prej 22 hektarëve, kështu që nuk mund të thuhet se nuk është bërë diçka në këtë fushë, gjithashtu është filluar edhe me procesin e certifikimit me Global Gap, andaj e përsërisë që nuk mund të thuhet se nuk është bërë asgjë në fushën dhe për përkrahje të fermerëve të mjedrës, andaj të thuhet, zero investime, për mua është joserioze, duke mos dashur të llogariti edhe subvencionimin me 70 sera dhe 550 shoqëri të bletëve, subvencione të cilat kanë ndikuar në ngritjen e punësimit në Komunën tonë. Prej që unë kam marrë detyrën e drejtorit të DBPZHR, nuk jam në dijeni me vetëdije të plotë që kemi bërë shpërndarjen e asnjë bagëtie – Lopë, çështje e cila është përmend edhe më parë, nuk e di se ku merren këto informata, por me përgjegjësi të plotë e them se nuk kemi bërë shpërndarjen e asnjë bagëtie, gjë të cilën e vërtetoj me çdo argument, mirëpo nëse ka donatorë të ndryshëm të cilët vijnë dhe gjejnë format e shpërndarjes së tyre është çështje e atyre donatorëve, por në DBPZHR as nuk ka ardhur askush dhe as nuk kemi bërë asnjëherë shpërndarjen e ndonjë bagëtie. Sa i përket asaj që u tha se shiten

subvencionet, ju rikujtoj se vetëm në vitin e kaluar tri herë radhazi si rezultat i informatave jo të vërteta kemi dal në terren me komision ku kemi vlerësuar shpërndarjen e subvencioneve që kemi bërë si Komunë. Mos të harrohet fakti se të gjitha subvencionet nga viti 2015 janë bërë përmes një kontrate të nënshkruar mes DBPZHR dhe fermerëve, ku përcaktohen qartë obligimet e fermerëve dhe të Drejtorisë si dhe masat që duhet të ndërmerren në organet gjegjëse në rast të keqpërdorimit. Shpërndarjen e sistemit të ujitjes nuk e kemi bërë me një sistem të zakonshmet apo të thjesht por është një sistem i qëndrueshëm afatgjatë për një periudhë kohore deri në 10 vite, kështu që i lejohej një fermeri të natyrshëm që prej përmishtës së vjetër sistemin e ujitjes ta bartë tek përmishtëja e re, andaj kjo nuk duhet të konsiderohet si keqpërdorim. Gjithashtu u potencua edhe rasti i subvencionimit me koshere të bletëve, e që ligji për bletarinë e parasheh se bletët mund të transferohen nga një vend në vendin tjetër për shkak të kullësve, dhe kjo nuk duhet të shihet si diçka tragjike. Konsideroj se çështjet të cilat u potencuan rreth keqpërdorimeve, duhet të ofrohen fakte të caktuara konkrete, përndryshe ne ashtu siç kemi dalë viteve të kaluara, edhe në këtë vit vazhdimisht do të dalim dhe do të përcjellim subvencionet të cilat janë krijuar prej të hyrave vetanake përkatësisht prej taksapaguesve të vetë Llapjanëve, kështu që ne si Drejtori do të mundohemi që edhe përcjelljen e tyre ta bëjmë në mënyrën më të mirë të mundshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa kuptova unë, drejtori parafolës nuk më paska dëgjuar mirë, e di se nuk e ka vëmendjen në ndonjë zhvillim, sepse nuk e thash se janë shpërndarë bagëti – Lopë, por e thash makina për mjelje, dhe nëse dëshironi ju tregoj edhe emrin e zyrtarit të LDK-së që e ka blerë një të tillë dhe kujt ja ka dhënë, por nuk jam këtu për ato punë. Pas storjes së suksesit që ka bërë USAID në perimekulturë në Komunën e Podujevës, jo vetëm drejtori parafolës por edhe shumë tjerë këtë storje e kanë prurë në 50% të një dështimi total, shtrohet pyetja pse, sepse parafolësi është drejtori i parë i cili ka vënë një kusht për fermerët e Podujevës që pa qenë anëtarë i shoqatës përkatëse të mos mund të marrin subvencione, gjë për të cilën unë në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e kam thënë se kjo nuk mund të jetë kusht për përfitim të një subvencionit, dhe pastaj ky Kuvend së bashku me LDK-në dhe këshilltarët tjerë e kanë hequr atë vendim tendencioz – të keq të drejtorit të DBPZHR, nëse nuk ka qenë ashtu urdhëro demantoje, por ju jeni ai drejtor i cili keni zgjedh atë metodë të qeverisjes. Çështje tjetër, drejtori i DBPZHR e ka degraduar, pa ndonjë kontakt, pa ndonjë takim, si çështjen e grumbullimit të mjedrave ashtu edhe çmimin e tyre, e që sot unë shumë dyshoj se me metodën që ky drejtor ka zgjedh të udhëheqë me këtë fushë, shumë pak qytetarë do të jenë të interesuar të merren me mjedra në Llap, duke filluar nga çmimi, grumbullimi, neglizhenca e shpërndarjes së subvencioneve etj. Unë jam në dijeni se drejtori nuk e cakton kompaninë, por a mundet drejtori parafolës të më tregoj, që nëse nuk keni mundur të subvenciononi fermerët me mjedra për një vit dhe ato tani në këtë kohë duhet të mbjellën, si do ta përzgjedhni në tri javët e ardhshme, pra rëndësia e kësaj fushe është e rëndësishme prandaj edhe idetë duhet të jenë të rëndësishme, por unë ju garantoj, përveç nëse e bëni në mënyrë jo ligjore, deri në muajin maj nuk do të jeni në gjendje që atyre fermerëve t’ju jepni as edhe një fidan të mjedrës, fermerë të cilët mua personalisht më dhimbsen sepse për një vit pronat ju kanë mbet pa mbjellë asgjë si shkak i paaftësive të drejtorit të DBPZHR për të gjetur rrugën për ta kryer atë punë. Nuk dëshiroj të bëjë replikë më të thellë rreth metodologjisë së drejtorit parafolës rreth qeverisjes së tij për të zhvilluar bujqësinë dhe perimekulturën në Podujevë, por vlen të ceket se jemi dëshmitar që i njëjti drejtor sa ka qenë edhe drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në Kuvend ka sjellë një plan me të cilin ka paraparë të zhvilloj ekonominë duke ndërtuar dy staza në fshatin Kërpimëh, gjë e cila për mua ka qenë ide shumë interesante.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), theksoi, fillimisht e falënderoj parafolësin për vlerësimet e bëra, dua të them se për një periudhë kohore që nga viti 1981 gjatë shkollimit tim jam vlerësuar, madje kam pas fatin të vlerësohem edhe nga akademikët, kështu që nuk dua të merrem me çështjen e vlerësimit. Parafolësi e përmendi çështjen rreth makinave mjelëse, kështu që edhe për këtë dëshiroj të potencoj se nga viti 2015 prej se kam marrë detyrën e drejtorit të DBPZHR nuk kemi subvencionuar askënd me makina mjelëse, andaj nuk jemi të obliguar të japim përgjegjësi për asnjë të kaluar, mirëpo mbajmë përgjegjësi nga marrja e detyrës tonë përkatëse, dhe në këtë aspekt, projekt për subvencionim me makina për mjelje nuk ka pasur, nëse parafolësi e gjen ndokund, të jap argumente, përndryshe të gjitha që u thanë janë jo serioze.

z.Flakron Gashi, theksoi, çështja e bartjes së të hyrave vetanake të Komunës nga viti 2016 në vitin 2017, prej rreth 0.8 milion euro tregon më së miri që kjo Komunë gjithherë nuk ka qenë e gatshme të gjeneroj të hyra vetanake dhe ka dështuar në këtë segment, mund të llogaritni sa është granti qeveritar, sa është parashikimi për inkasimin e të hyrave vetanake dhe në këtë kontekst dhe në këtë hap, Komuna e Podujevës ka humbur miliona euro si pasojë e mos efijencës dhe mungesës së gatishmërisë për të vjelë të hyrat vetanake, gjë e cila bëhet edhe sot por jo në mënyrë të kënaqshme, dhe kështu është krijuar një klientelizëm tek pronat të cilat jepen në shfrytëzim dhe dihet kush i menaxhon dhe kush bartë me ato. Sa i përket projekteve, dikush po zotohet dhe po thotë që këto projekte janë në interes të qytetarëve, unë nuk di se cili projekt nuk është në interes të qytetarëve, por këto para janë publike dhe janë para të qytetarëve, dhe nuk janë para të Lidhjes Demokratike të Kosovës, as të zotëri Veliut e as të drejtorëve përkatës, andaj nuk do të doja të hymë në këto polemika dhe të luajmë me interesin e qytetarëve. Unë i gëzohem ndërtimit të objektit të shkollës në fshatin Llapashticë, por ashtu siç e thanë edhe parafolësit, nuk është në interes që vetëm në atë fshat të ndërtohet objekt i ri, por ka nevojë të shumta që investime apo ndërtime të tilla të zgjerohen edhe në rrafshet tjera dhe në objekte tjera shkollore. Sa i përket çështjes së subvencionimit me mjedra, unë e përcjella me vëmendje diskutimin e drejtorit të DBPZHR, dhe jam shumë i bindur që drejtori proceduralisht nuk e përzgjedh kompaninë dhe për këtë ne jemi të vetëdijshëm, por proceduralisht kjo Drejtori me ekip është e obliguar të përpiloj listën në bazë të kriterëve të cilët meritojnë të përfitojnë një subvencion, por as këtë nuk e bënë ose në rastet të caktuara ajo listë vjen shabllon nga individ të tjerë duke shpërdoruar kriteret dhe procedurat e parapara. Ndoshta drejtori z.Avni Fetahu nuk është në dijeni, por ky subvencionim nuk është bërë për një arsye brenda ose mbrapa së cilës janë fsheh interesat të caktuara, dhe jo për faktin që ka aplikuar - konkurruar vetëm një kompani e cila ka qenë e papërgjegjshme, por të nderuar kolegë, unë kam informata të mjaftueshme, se kompania e parapërcaktuar për të përfituar këtë tender, ka qenë një kompani nga një Komunë tjetër e cila në mënyrë të kontrabanduar ka dashur të sjellë fidanë në Kosovë të cilat kanë qenë të sëmura me të cilat jo vetëm që do të dështonin dhe buxheti do të shkonte huq, por edhe për pesë vitet e ardhshme ajo tokë në të cilën do të mbjellej ai fidan do të sëmurej dhe nuk do të kishte asnjë produktivitet në asnjë kulturë. Ky fenomen fatkeq nuk është ndalur nga organet komunale, edhe pse ndoshta disa kanë mundur ta dinë ose mos ta dinë, mirëpo është ndalur nga institucionet tjera. Dhe kur jemi tek bartjet e të hyrave nga një vit në vitin tjetër jo vetëm se realizohen interesat në projekte të caktuara por kjo tregon se ne humbim shkallshmërinë për një vit dhe tani projektet që duhet të kryhen në vitin e ardhshëm nga realizimi i të hyrave vetanake del që të bartet në një vit tjetër gjë e cila tregon një hap jo të mirë drejt inkasimit të të hyrave vetanake dhe etiketimit të nxjerrjes në vlerë politike.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, ende nuk e kemi raportin financiar për të vërtetuar më hollësisht operacionet financiare, por sigurisht muajin e ardhshëm do ta shihni një gjë të tillë. Në DSHPMSH vitin e kaluar borxhi publik ka qenë 3800.00 €, ndërsa të gjitha mjetet financiare të cilat barten në kuadër të DSHPMSH janë për projekte dy vjeçare, gjë për të cilën jeni në dijeni se procedurat e prokurimit lejojnë projekte dy a më shumë vjeçare nëse ai projekt është i miratuar paraprakisht në Kuvendin e Komunës, dhe në këtë kontekst të gjitha këto projekte janë të miratuara paraprakisht sipas procedurave përkatëse dhe tani kërkohet buxhet shtesë i cili krijohet ose nga të hyrat vetanake, ose nga rishikimi ose nga ridestinimi apo eventualisht nga donatorët, fundja për vitin e ardhshëm ai projekt duhet të jetë në harmoni me kontratën dhe buxhetin përkatës, prandaj këto tri projekte që janë në kuadër të DSHPMSH janë plotësuar në bazë të këtyre kriterëve, pra nuk ka ndonjë projekt të ri ose ndonjë projekt që nuk është miratuar në Kuvendin e Komunës. z.Haki Rudari disa herë ka kërkuar të precizohen bartjet e mjeteve financiare për secilin projekt, shembull, tek trotuaret, kontrata për ndërtimin e trotuareve është dy vjeçare dhe nuk përfshin vetëm një fshat ose rrugë, por përfshinë shumë rrugë e që unë mund të përmendi disa prej tyre, por nuk është me rëndësi se ato mjete a shkojnë në fshatin Shajkoc apo ndonjë fshat tjetër, por duhet të shkojnë brenda kontratës, do të thotë se nuk ka ndonjë definim të saktë se ku shkojnë ato mjete sepse është kontratë e përgjithshme, ndërsa punë tjera janë punë të brendshme operacionale. Shpresojmë që me këtë bartje e cila në këtë vit po duket paksa e lartë e që kryesisht arsimi dhe Bujqësia e kanë rritë bartjen e këtyre të hyrave sepse pothuajse për çdo vit kemi pasur rreth 300,000.00 € bartje nga të hyrat vetanake që realizohen dy muajt e fundit të vitit të kaluar. Unë pajtohem plotësisht se më mirë do të ishte të shpenzoheshin në vitin paraprak se sa që barten në vitin vijues, mirëpo nuk ka ndonjë qëllim dhe ato mjete nuk humbin sepse në një mënyrë këto projekte kanë mbetur me mungesë të mjeteve buxhetore andaj duhet të plotësohen, ndërsa ne si Drejtori nuk e kemi pasur atë problem sepse më së paku kemi pasur të hyra kështu që edhe shuma e bartjes është e vogël.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), theksoi, sa i përket çështjes së potencuar rreth kompanisë, më habit fakti që kinse ajo kompani paska qenë e parapërcaktuar atëherë nuk e di përse nuk ka aplikuar. Në fakt, ne kemi pritur kompani serioze sepse ka qenë një shumë bukur e madhe në krahasim me Komunitatet tjera, ndërsa dy herë radhazi e njëjta kompani nga Gjakova ka aplikuar. Sërish e them se më habit fakti që gjoja një kompani ka qenë e parapërcaktuar dhe nuk ka aplikuar fare për ta fituar tenderin dhe për të bërë shpërndarjen e fidanëve të mjedrës. Po ashtu jua rikujtoj se listën e kriterëve nga ky vit vetëm e kemi pasuruar edhe më shumë ku secili fermer që ka aplikuar i ka pasur kriteret e qarta me të marrë formularin, e them këtë sepse në thirrjen për aplikim nuk qiten të gjitha detajet, por është formulari ai i cili i përcakton ato detaje ndërsa pastaj Komisioni është ai i cili i vlerëson.

Më parë z.Rafet Llapashtica e tha që kinse DBPZHR ka vënë kushte për aplikim, ju rikujtoj se në propozim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, nga Shoqata përkatëse është sjellë një propozim me të cilin është kërkuar të jetë si kusht për tu anëtarësuar në Shoqatë të gjitha ata që aplikojnë për fidan të mjedrës, ndërsa proceduralisht unë atë propozim e kam sjellë në Kuvend, nuk është votuar nga këshilltarët dhe kaq, asgjë nuk ka të keqe në këtë aspekt, dhe mos e merrni këtë kinse unë kam këmbëngul apo diçka tjetër sepse unë as nuk jam i anëtarësuar në atë Shoqatë, as nuk e përfaqësoj atë, por thjesht ka qenë një propozim, e kemi sjellë, nuk ka kaluar dhe asgjë tjetër nuk ka pasur rreth kësaj.

z.Flakron Gashi, theksoi, më vie shumë keq që drejtori parafolës nuk ka informata më shumë, por përse ajo kompani nuk ka aplikuar duhet ta keni përgjigjen ju drejtor, dhe po ashtu jeni në dijeni shumë mirë që ka qenë problem medial ky, ndërsa më vie shumë keq që ju drejtor nuk e keni ditë sepse asaj kompanie i ka dështuar ky lloj allashverishi për arsye se ato mjedra të cilat kanë dashur të sjellën në Komunën e Podujevës, me gjasë edhe në Komuna tjera, kanë qenë të sëmura dhe të infektuara. Kur flasim për kritere të subvencionimit, më duhet të lidhem me një fjalë të cilën më herët e potencoj Kryesuesi i Kuvendit, kur e tha që raporti i auditorit të përgjithshëm është më i besueshëm dhe atij i referohemi dhe atë e marrim për bazë. Ky raport të cilin ju e njihni si më të besueshëm në vitin e kaluar e ka cekur edhe çështjen e subvencioneve dhe tranfereve, konkretisht tek Drejtoria të cilën drejtori parafolës udhëheq me atë, dhe atë thuhet specifikisht që në mesin e atyre të cilët kanë plotësuar kriteret për të qenë përfitues, ata të cilët kanë përfituar dhe kanë dal në lista si përfitues, neve nuk na është dhënë shpjegim se cilat kritere kanë qenë shtesë të cilat ata i kanë plotësuar dhe që janë përfitues. Këtë nuk po e them unë, por e thotë një raport i cili deri diku edhe unë besoj që është i besueshëm, por jo aq sa beson Kryesuesi.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, dua të ndërlihem tek Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, pyetja ime është konkrete, dhe më vie mirë që vetëm kur po dalim në foltore po iu bie ndërmend për neglizhencën që jeni duke e bërë ndaj qytetarëve. Fjala është për një rrugë e cila është në prioritet që nga viti 2013, për të cilën jemi në dijeni të gjithë se projekti është paguar nga vetë qytetarët por i njëjti gjendet në sirtarin e Drejtorisë, kështu që më intereson ta di se në kuadër të meremetimit të rrugëve me zhavorr në shumë rreth 49,000.00 €, përkatësisht kemi të bëjmë me rrugën e Lagjes Merovci të cilën edhe vetë drejtori e ka vizituar ku edhe sigurisht e ka vërejtur se është në gjendje të mjerueshme ndërsa nuk keni qenë në gjendje që të shtroni 3-4 kamion me zhavorr, rrugë e cila është çështje jetike për ato familje, vlen të ceket fakti se as vetura e drejtorit nuk ka mund të kaloj nëpër atë rrugë, andaj më vie shumë keq që po bëni neglizhencë ndaj qytetarëve dhe pastaj po iu bie ndërmend vetëm atëherë kur ne po dalim në foltore, si dhe më erdhi shumë mirë që drejtori në fjalë posa mora fjalën e përmendi atë Lagje, mirëpo po konsideroj se neglizhencën e keni në rend të parë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se për këtë pikë të rendit të ditës u diskutua mjaft gjerë. Po ashtu jeni në dijeni se bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak është e rregulluar me ligj dhe ato mjete nuk humbin, pra të gjitha këto mjete barten në projekte të miratuar në vitin e kaluar. Këshilltarja znj.Adelinë Stublla e paraqiti një propozim, të cilin nuk dëshiroj të hedh poshtë mirëpo jam në dijeni se një prej Komunave të Kosovës e ka marrë një vendim të tillë por pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është vlerësuar se nuk ka bazë ligjore. Me që nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë propozim vendimin sipas materialit të dërguar.

Pas votimit u konstatua se me 30 vota për, asnjë votë kundër dhe 4 vota të përmbajtura, u miratua propozimi i vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2016 në vitin 2017 dhe destinimi në kategori të caktuara buxhetore

4. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ-në HANDIKOS – Qendra e rehabilitimit të bazuar në bashkësi

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për njoftim dhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar për këtë propozim dhe njëzëri i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, madje ka pasur kërkesa lidhur me shumën e mjeteve buxhetore për të cilën është thënë se është mjaft modeste dhe është e nevojshme të ndahet buxhet më i madh për këtë kategori, andaj besoj se edhe sot në këtë mbledhje për këtë propozim jemi njëzëri që ta mbështetim Handikosin, e hapi diskutimin.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, në mbledhjen e KPF-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozim dhe të gjithë anëtarët ishim njëzëri që ky propozim vendim të mbështetet, ashtu siç ishim edhe për rendin e propozuar të ditës, e që për çudi sot disa ishin kundër këtij rendi të ditës. Ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrahim propozim vendimin për mbështetje financiare OJQ-në Handikos, dhe mendojmë se është një veprim mjaft i mirë dhe i rëndësishëm nga ana e Komunës së Podujevës që në vazhdimësi është duke e mbështet qoftë financiarisht qoftë në forma tjera këtë Organizatë. I lutemi Zotit që të kemi sa më pak raste në fjalë, mirëpo me të gjitha mundësitë tona që i kemi ne gjithherë jemi në gatishmëri të plotë t'i mbështetim ata, një gjë të tillë e kamë thënë përherë dhe po e përsëris se ne si Grup nga radhët e LDK-së, vazhdimisht do t'i mbështetim këtë kategori.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështetim këtë propozim vendim përkatësisht e mbështetim kategorinë në fjalë, dhasht Zoti që kjo kategori të bënë më mirë, ndërsa për ta ndihmuar dhe mbështetur e kemi obligim moral dhe njerëzor. Edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë mbështetje ku edhe kam kërkuar që kjo shumë e propozuar e mjeteve financiare të rritet për arsye se kemi të bëjmë me njerëz të cilët kanë probleme shëndetësore, andaj moralisht në bazë të mundësive financiare të përkrahet me shuma sa më të mëdha. Do të ishte mirë që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të merrte një evidencë edhe për organizatat tjera, siç janë, ajo e sindrom down, pastaj e shurdhmemecëve, e autizmit etj. Shuma prej 14,938.00 € e propozuar për Handikos e cila numëron rreth 900 anëtarë, mendoj se është shumë e vogël e mjeteve me të cilën vetëm do të funksionojnë si administratë dhe për identifikim ose diçka ngjashëm, përndryshe ne si Grup i këshilltarëve, këtë propozim vendim përkatësisht këtë kategori të njerëzve do ta mbështetim me aq sa neve na lejojnë mundësitë.

z.Bahri Selimi, theksoi, sa i përket përkrahjes së këtij propozim vendimi për mbështetje financiare për OJQ Handikos, mendoj se të mos përkrahet një iniciativë e tillë do të ishte një absurditet i madh. Shuma prej 14,938.00 € e propozuar për mbështetje të kësaj kategorie mendoj se është vetëm një shumë simbolike sepse do të duhej të ishte një shumë më e madhe krahasuar me nevojat që kanë këta persona e që edhe vetë titulli për ta është, persona me nevoja të veçanta, andaj edhe kanë nevoja shumë të mëdha. Ne po diskutojmë për këtë kategori, mirëpo ajo që më bëri përshtypje është se ne po diskutojmë për një çështje që është për OJQ-në Handikos, por asnjëherë nuk kemi statistika edhe për disa kategori tjera siç janë; fëmijët me sindrom down dhe ata me autizëm, të cilët unë mendoj se kanë shumë nevojë për një mbështetje edhe përkundër asaj që, sa unë jam në dijeni, për ato kategori sigurohet transport nga shtëpitë e tyre deri te shkolla e fshatit Gllamnik. Mendoj se Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës duhet të ndërmarrin edhe më shumë iniciativa të tilla, vlen të ceket se kohë më parë kemi pas kërkesë edhe nga Shoqata e invalidëve të luftës për të cilët mendoj se edhe ata njerëz janë me nevoja të veçanta dhe kanë nevoja të mëdha për mbështetje, kërkesë e cila është bërë para dy seancave por që e

njëjta është arsyetuar se nuk kemi mjete buxhetore për mbështetjen e atyre personave edhe pse shuma e kërkuar ka qenë simbolike vetëm sa për mirëmbajtje të zyrës së tyre dhe gjërave personale të tyre, por nuk i kemi mbështetë, prandaj kërkoj që të kemi konsideratë edhe për Shoqatën e invalidëve të luftës sepse me faktin që teprojnë rreth 190,000.00 € prej investimeve dhe subvencioneve që nuk janë shfrytëzuar, besoj se shuma prej 14,938.00 € për mbështetje OJQ-në Handikos, pastaj rreth 15,000.00 € dhe shuma prej 10,000.00 € për marrje të statistikave për persona tjerë të kategorive tjera që kanë nevojë për mbështetje, besoj se është një punë shumë e vogël, prandaj kërkoj që edhe kërkesat tjera që vijnë prej qytetarëve dhe Shoqatave të ndryshme të merren në konsideratë ashtu siç merret OJQ Handikos për çdo vit, edhe pse po e përsëris që këta persona ne po i mbështetim vetëm simbolikisht.

z.Kadri Avdiu, theksoi, nuk kemi dilema se a duhet apo jo të mbështetet OJQ Handikos, gjë e cila u tha edhe nga parafolësit, mirëpo tani dolën disa dilema të cilat janë pak më ndryshe, por në bazë të dokumentacionit kjo kërkesë është bërë nga OJQ Handikos dhe tani nga Kuvendi i Komunës vetëm kërkohet miratim apo jo, dhe nuk kemi çka t'i shtojmë kësaj sepse kërkesa në fjalë është me argumente, e jo vetëm shuma e kërkuar, kështu që a duhet të mbështetet apo jo ne nuk kemi çka të diskutojmë, natyrisht se duhet të mbështetet. Sa i përket asaj që parafolës z.Bahri Selimi e tha që duhet të merremi edhe me invalidë të luftës, mendoj se invalidë të luftës janë bërë aq shumë që as buxheti i Kosovës nuk mund t'i mbulon, dhe nuk ka kuptim që të krahasohen me personat me nevoja të veçanta, kur e thash që janë bërë shumë invalidë të luftës, nuk e pata fjalën për ata të cilët janë vërtetë.

z.Bahri Selimi, theksoi, sa e vërejta, parafolësi më ka keqkuptuar ose nuk më ka dëgjuar mirë sepse ka qenë duke biseduar me kolegët e tij afër. Unë nuk kërkoja mbështetje për t'iu bërë paga atyre invalidëve të luftës ngase ne nuk ju bëjmë paga as rreth 900 personave të Handikos-it, mirëpo ne e mbështetim mirëmbajtjen e zyrës dhe aktiviteteve të tyre që e bëjnë në terren, prandaj edhe invalidët e luftës kanë kërkuar mbështetje për mirëmbajtjen e zyrës apo një shumë për aktivitete të tyre të cilat i kryejnë në terren. Edhe unë pajtoj me parafolësin që as buxheti i Qeverisë nuk po mund t'iu siguroj paga e lëre më ne.

z.Kadri Avdiu, replikë parafolësit, theksoi, nuk e thash për paga, por e thash se aq shumë janë bërë invalid të luftës, por nuk e pata fjalën për ata të cilët vërtetë janë invalid të luftës për të cilët kam çdo respekt sepse ka atillë që kanë humbur gjymtyrët e trupit dhe kanë nevojë edhe për mbështetje më të madhe pavarësisht pagës. Pra e thash që janë bërë shumë, dhe kjo mbetet të verifikohen saktë që ne ta kuptojmë, andaj të mos keqkuptohemi sepse kjo mund të merret ndryshe pastaj, ngase unë nuk e pata fjalën për paga edhe pse për ata që janë vërtetë invalid të luftës po, i mbështes gjithherë, por jo për ata që janë bërë shumë.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, konsideroj se është e padiskutueshme përkrahja e kategorisë së personave me nevoja të veçanta për të cilët mendoj se shuma e propozuar është e vogël në krahasim me nevojat e tyre, mirëpo unë edhe dje në mbledhjen e KPF-së ka shtruar pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pyetje të cilën dua të përsëris edhe sot këtu. Kjo ka të bëjë me vizitat e para e që në vitin 2016 janë 55 të tilla, ndërsa për vizitat tjera për rastet që janë me dekubitus e që janë vetëm 39 mendoj se është mjaft shqetësuese, andaj pyetja është, a keni të drejtë që të mbikëqyrni se si trajtohen pacientët e prekur me dekubitus, e që mendoj se keni të drejtë, dhe a ka kapacitet OJQ Handikos të trajtoj këtë kategori përkatësisht trajtimin adekuat të këtyre pacientëve, jemi duke fol për dekubitusin që është një sëmundje e cila kërkon trajtim të veçantë.

z.Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS), theksoi, shuma e paraqitur për mbështetje financiare OJQ-në Handikos ka qenë kërkesë e po kësaj OJQ-je ku edhe është përfshirë një përshkrim i detajuar qoftë nga ana financiare qoftë për shërbimet e tyre që i kryejnë në terren. Sa i përket ndihmës edhe për kategoritë tjera nga ana e DSHMS, ju bëjë me dije se të gjitha kërkesat individuale ndihmohen vazhdimisht nga ana e Drejtorisë varësisht sipas nevojave të tyre, por jo atyre në formë të shoqatave për arsye se jo të gjitha janë serioze dhe jo të gjitha kanë numër të madhe që mund të përkujdesen për anëtarët e tyre, mirëpo individualisht i përkrahim të gjithë. Sa i përket OJQ-së Handikos, kjo ka një numër rreth 900 anëtarë e që nuk është një numër i vogël dhe vizitat në terren, ashtu siç e përmendi edhe këshilltarja parafolese janë 55 vizita apo raste për herë të parë, janë për herë të parë sepse janë lajmëruar në Handikos për herë të parë, dhe janë hulumtuar si raste të reja, prandaj edhe janë vizita për herë të parë. Sa i përket trajtimit adekuat për rastet e dekubitusit, vërtetë është shqetësuese numri i paraqitur këtu, por jo të gjitha rastet janë me dekubitus, por Handikos i ka përshkruar si raste të mundura për arsye se ato raste janë në karroca madje ndoshta edhe të palëvizshëm ose që pa ndihmën e dikujt nuk mund të lëvizin, pra kjo është arsyeja pse janë përshkruar si raste dekubituese. Për rastet e identifikuara me këtë diagnozë, OJQ Handikos kujdeset deri në atë masë që lejohet brenda kornizave dhe mundësive të tyre, mirëpo në rastet kur Handikos nuk ka mundësi t'i trajtoj, informohet QKMF-ja në Podujevë ku pastaj ekipet përkatëse intervenojnë aty ku paraqitet nevoja. Sa vërejta deri tani të gjithë këshilltarët jeni për mbështetjen e OJQ-së Handikos gjë për të cilën ju përshëndes dhe ju falënderoj.

z.Flakron Gashi, theksoi, mendoj se është e rëndësishme të bëhet vetëm një sqarim ose ndarje, apo në qoftë se drejtori i DSHMS e ka këtë informatë, të na tregoj, shërbimet të cilat i kryen OJQ Handikos, të gjitha rastet, sa prej këtyre rasteve, a ka raste dhe cilat prej tyre nuk janë dhe nuk trajtohen nga kujdesi primar shëndetësorë, obligim i cili është në kuadër të nivelit lokal të qendrave klinike të mjekësisë familjare, si dhe a ka raste të cilat duhet të kenë trajtim në klinikë universitare gjë për të cilën mendoj se është shumë e rëndësishme të dallohet, dhe rastet kur ka të bëjë që ata pacientë duhet të kenë trajtim klinik universitar, mendoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm sepse a kanë kapacitete dhe përgatitje të mjaftueshme profesionale anëtarët e epikes së Handikos në Podujevë të trajtojnë ato raste, ose në të kundërtën mund të rrezikojnë edhe më tej shëndetin e tyre. Unë i qëndroj parimit të asaj që e cekëm se aktivitetet e tilla i kemi mbështetë kur është në pyetje mirëqenie sidomos e këtyre kategorive.

z.Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, sa i përket çështjes së ngritur nga parafolesi, e vërteta është se në rastet kur OJQ Handikos në Podujevë hasin në raste të tilla bëjnë trajnime dhe trajtime të veçanta përmes punëtorëve që kanë në dispozicion, ndërsa në rastet të cilat kanë nevojë për trajtim të mëtutjeshëm, Handikos i lajmëron në QKMF – Podujevë të cilat pastaj përcjellën në klinikë. Ndihma e cila ofrohet nga Handikos për ato kategori, nuk është vetëm ndihmë me shërbime të punëtorëve por ndihma bëhet edhe gjëra të ndryshme të cilat nuk janë financiare për rastet në nevojë, dhe përmes donacioneve njëkohësisht Komuna e Podujevës disa herë ka siguruar karroca dhe pajisje tjera ndihmëse të cilat përmes Handikos kanë arrit tek rastet me nevojë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se rreth kësaj pike u sqaruam të gjithë dhe nuk pati kundërshtime nga askush, andaj e hedh në votim propozim vendimin në fjalë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ-në HANDIKOS – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, në Podujevë.

5. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe -Plani i punës i KKSBB-së për vitin 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe këtë pikë e kemi shqyrtuar në mbledhjen e KPF-së, dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim të informatës përkatëse dhe njëkohësisht shqyrtimin dhe miratimin e Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2017, mirëpo si do që të jetë, fjalën hyrëse do ta paraqet drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit i cili njëkohësisht është edhe Koordinator i KKSBB-së në Podujevë.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH) i cili njëkohësisht është edhe Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ju njoftoj se fillimisht janë ngritur dy grupe punuese, kemi punuar mjaft në përgatitjen e kësaj informate dhe këtij plani të punës. Për këtë informatë nuk do të ndalem shumë sepse është vetëm një informatë në të cilën ne si grup kemi marrë të gjitha mbledhjet brenda vitit, sipas planit përkatës të punës, dhe ne si grup punues përgatitur këtë material i cili është bukur voluminoz me qëllim që këshilltarët e Kuvendit dhe opinioni në përgjithësi të jetë sa më i informuar. Sa i përket Planit të punës të KKSBB-së për vitin 2017 i cili duhet të shqyrtohet dhe t'i nënshtrohet votimit nga Kuvendi i Komunës, është plan që në krahasim me vitin e kaluar është pasuruar dhe përmirësuar edhe me disa aktivitete të tjera, siç janë; informata për projektin e vendosjes së kamerave të sigurisë në qytet, projekt ky i cili do të realizohet nga Komuna e Podujevës së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme – Policinë e Kosovës, jemi në fazën e përgatitjes së projektit sipas të cilit do të bëhet vendosja e kamerave të sigurisë në disa rrugë të qytetit të cilat konsiderohen më të arsyeshme në funksion të ngritjes së sigurisë qoftë sa i përket komunikacionit qoftë rasteve tjera delikuede dhe të tjera, por më gjerësisht do të informoheni kur projekti të jetë në fazën e implementimit. Çështja tjetër ka të bëjë me problemin e geneve endacak, sigurisht të gjithë jemi në dijeni se me këtë problem ballafaqohet edhe Komuna e Podujevës ashtu siç ballafaqohen edhe të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, sepse ekziston legjislacioni përkatës i cili ka të bëjë me mbrojtjen e kafshëve, mirëpo në takimet e shumta të Kryetarëve të Komunave me organet përkatëse të nivelit qendrorë dhe Agjencisë së veterinars dhe ushqimit si dhe me strukturat tjera relevante janë duke bërë përpjekje që këtë problem ta zgjedhin sa më shpejt dhe nga kjo varet edhe Komuna jonë. Po ashtu dëshiroj të ndalem tek informata e paraparë për implementimin e planit operativ lokal sipas strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm, Strategji e nxjerrë nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës e cila pastaj iu është shpërndarë Komunave, ju informoj se KKSBB në Komunën e Podujevës e ka diskutuar këtë çështje dhe ka ngritur Grupin operativ komunal, është hartuar dhe paraqitur plani përkatës i cili pastaj është miratuar në KKSBB dhe i cili nga java e kaluar ka filluar të zbatohet sipas programit. Po ashtu kemi vlerësuar se është e nevojshme të paraqitet edhe një informatë për gjendjen e pyjeve sepse bazuar në vitet e kaluara kemi menduar që mund të kemi probleme me prerje ilegale, me djegie të pyjeve etj, probleme të cilat është e nevojshme të shqyrtohen në KKSBB ku paraqiten raportime Drejtoria përkatëse, nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës por edhe nga organe tjera gjegjëse, ndërsa sa i përket kërkesës që këto çështje të shqyrtohen edhe në Kuvendin e Komunës, kjo është çështje e juaja dhe mund ta miratoni atëherë kur ju e shihni të nevojshme. Dje në mbledhjen e KPF-së ka qenë një kërkesë që Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë të raportoj në Kuvend për gjendjen e sigurisë në Komunë, dhe unë kam biseduar edhe me Kryesuesin e Kuvendit, por këtë çështje mund ta bisedojmë edhe me Komandantin e Stacionit të Policisë në Podujevë dhe ndoshta në një prej seancave të radhës të

kemi një raportim të tillë e që do të ishte e mirëseardhur të diskutohej edhe për problemet e sigurisë dhe çështje tjera brenda territorit të Komunës së Podujevës. Po ashtu ju informoj se në vitin 2016 të gjitha pikat e parapara me Plan të punës janë realizuar, madje ka pasur edhe pika tjera shtesë, andaj shpresojmë që edhe në këtë vit do të realizohen të gjitha pikat e parapara.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së kemi shqyrtuar dhe analizuar informatën e KKSB-së për vitin 2016 dhe planin e punës për vitin 2017, plan për të cilin mendojmë se është mjaft i mirë, praktik dhe operativ, mirëpo do të dëshironim të kushtohet vëmendje më e madhe tek nxënësit e shkollave të mesme duke pasur koordinim të mirë edhe me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, këtë e them duke qenë i informuar për raste të ndryshme ku më i freskëti është ai i një dite më parë, edhe pse ky rast kishte ndodhur nga jashtë, prap do të kërkoja që të shikohen mundësitë që siguria në shkolla dhe ambiente të shkollave të jetë më e lartë në tri shkollat e mesme të Podujevës. Po ashtu meqë u diskua edhe për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet, propozoj që në kuadër të mundësive, përveç rrugëve kryesore të shkollave, kamera të tilla të vendosen edhe në oborre të shkollave për shkak se ne vazhdimisht shohim qarkullim të personave të cilët nuk janë pjesë e atyre shkollave por që shkojnë për çështje tjera. Po ashtu kërkoj që të përgatitet edhe një plan nga Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe me Policinë e Kosovës me qëllim të ofrimit të sigurisë sa më të madhe për nxënësit e shkollave, duke përfshirë këtu edhe parandalimin e përdorimit eventual të substancave jo të lejueshme, sepse jemi në dijeni se ata nxënës janë në moshën më vitale që mund të bien pre e grupeve të ndryshme kriminale që mund të ketë, të cilët pastaj mund të kenë interesa të ndryshme, pra edhe njëherë kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që në bashkëpunim të ngushtë me KKSB-në dhe me Policinë e Kosovës t'i kushtojnë vëmendje të jashtëzakonshme nxënësve të shkollave të mesme të Podujevës, sidomos në këtë periudhë. Këtë e them në bazë të asaj që na thuhet në takime të shumta që kemi me të rijnë të cilët thonë se ka raste që kanë filluar nxënësit e shkollave të mesme përmes personave nga jashtë që sillen afër shkollave, t'iu imponohen disa veprimtari jo të mira nxënësve të shkollave të mesme.

z.Flakron Gashi, theksoi, meqë jemi duke diskutuar për sigurinë në bashkësi dhe për një raport të sjellë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Podujevës, nuk mund të anashkalojmë një dyzetetetë orësh, të zi do ta quaja, ku brenda kësaj periudhe kanë ndodhur dy aksidente të tmerrshme, njëri aksident trafiku me fatalitet me humbje të jetës së një të riu, dhe një aksident tjetër brenda objektit shkollore ku është plagosur një nxënës. Në emër të këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës-Dega në Podujevë, u shprehim ngushëllime të dy familjeve veçanërisht atyre që kanë humbur familjarin dhe të afërmin e tyre, dhashtë Zoti që për këto familje të jetë e fundit, ndërsa i riu të merr tretmanin e duhur dhe të shërohet sa më shpejt.

Brenda dyzetetetë orëve të ndodhin dy aksidente nuk mund të themi se situata është relativisht e mirë, dhe unë besoj se të gjithë neve bashkërisht na bashkon çështja e sigurisë së qytetarëve, mirëpo dikush ka më shumë përgjegjësi kurse dikush më pak. Po ashtu besoj se fenomene të tilla ndodhin edhe për një arsye ku të gjithë jemi të vetëdijsëm se në Komunën e Podujevës, Stacioni Policorë në nivel lokal ka mungesë të pjesëtareve të Policisë, dhe Kryetari i Komunës si Kryetar edhe i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi duhet të bëjë çmos dhe të ndjek të gjitha rrugët ligjore dhe të kërkoj që numri i policëve në Stacionin e Policisë në kuadër të Komunës së Podujevës të jetë më i madh sepse siç jemi në dijeni ne jemi Komuna me territorin më të madh në nivel të Republikës së Kosovës. Është shumë e drejtë ajo që e tha këshilltari parafolës z.Fidan Rekaliu, që sot veturat e huliganëve që më së paku janë nxënës dhe qytetarë të denjë dhe të mirëfilltë, oborret e shkollave të mesme fatkeqësisht i kanë shndërruar në rreth rrotullime ku hyn dhe dalin sikur të jenë në "bahçe t'babës", më vie keq që po shprehem kështu por ashtu po ndodh.

Pastaj zhvillohen shpejtësi jashtë çdo limiti dhe rregullave të komunikacionit rrugorë në afërsi të shkollave të mesme duke mos përjashtuar edhe rrugëve tjera rajonale dhe regjionale brenda territorit të Komunës së Podujevës. I nderuari drejtor, unë bëj ftesë dhe apel që të keni takime më të shpeshta dhe më të rregullta me Komandantin e Stacionit të Policisë në Podujevë, dhe ta ngrisni këtë shqetësim që gjatë ndërrimeve të orareve në shkolla që zakonisht ndodhin në mes ditë, patrullimet e Policisë të jenë më të shpeshta dhe në kontinuitet të ketë një patrullë të Policisë e cila qëndron rreth këtyre shkollave. Po ashtu rastet e tilla nuk duhet të heshtur, gjithashtu kemi raste që brenda lokaleve dhe kafiterive në vitin që shkoi nga të rinjtë ka pasur nxjerrje të revoleve prej brezi, shtënie në rrugë, pastaj të rinjë ose grupe të rinjesh të cilët po tentojnë t'i shndërrojnë shkollat në çerdhe ku mund të përgatiten kriminelët e rrugëve të ardhshme, dhe të jeni në dijeni se në dy shkollat fillore "Shaban Shala" dhe "Naim Frashëri" unë kam një gjysmë informatë, nuk do të doja të ishte ashtu mirëpo kjo ekziston, që nxënësve u kërkohen nga grupe të caktuara 1€ - 2€ për t'iu mos iu nxjerrë problem atyre, çështje për të cilën sugjerim imediat është takim me drejtorët e atyre shkollave, takim me prindër, takim me Këshillin e prindërve, takim me mësimdhënësit, takim me policë si dhe të rritet numri i policëve civil ose hetues të cilët duhet të qëndrojnë rreth këtyre shkollave sepse për asnjërin prej nesh nuk do të ishte i kënaqshëm ndonjë rast i tillë siç ishte ai brenda objektit të shkollës teknike, që mund t'i ndodh një nxënësi të një shkolle fillore dhe ne si Komunë ta fitojmë një epitete jo të këndshme. Besoj që sa i përket kësaj çështje nuk do të na ndajnë qëndrimet politike sepse ata nxënës mund të jenë fëmijë të gjithëve.

z.Haki Rudari, theksoi, me rastin e incidentit që pati ndodhur në brezin kufitar Kosovë - Serbi që kishte humbur jetën një qytetarë, ne atëherë patëm kërkuar që të raportoj Komandanti i Stacionit të Policisë, kërkesë të cilën e kam përsëritë edhe dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa gjë të cilën po e përsëris edhe sot këtu sepse është kërkesë e arsyeshme që Komandanti i Stacionit të Policisë të raportoj para këshilltarëve të Kuvendit, praktikë e cila ndodh në shumë Komuna tjera. Sa i përket kësaj informate, do të thoja se është jo e plotë dhe në disa raste e cunguar. Në këtë informatë, në faqen 2 vërehet se Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë e pranon se ka 14 polic më pak, saktësisht thuhet, Stacioni i Policisë në Podujevë duke përfshirë edhe nën Stacionin e Policisë në Orllan duhet të ketë 91 zyrtar policor, e që aktualisht janë 77, pra 14 më pak, andaj konsideroj se kjo është në kundërshtim me ligjin, madje nëse i referohemi periudhave të ndryshme duke marrë për bazë pushimet e tyre nganjëherë mungesa e tyre është shumë më madhe, dhe po ta marrim dhe ta përkthejmë në sigurinë e qytetarëve, del se këtë mungesë po e pësojnë qytetarët e Komunës tonë. Pastaj në të njëjtën faqe thuhet, vërehet shtimi i veprave penale të vjedhjeve krahasuar me një periudhë të kaluar dhe është diçka që ne duhet ta diskutojmë. Po ashtu gjatë raportimit vërejtja një lloj arsyetimi që e paraqet Komandanti që sipas tij kjo është si pasojë e mungesës së personelit, pra njëherë Komandanti thotë se kemi mungesë të personelit 14 më pak, ndërsa mandej i njëjti mundohet t'i arsyeton vjedhjet për shkak të mungesës së personelit, gjë e cila mendoj se nuk arsyetohet sepse është çështje ligjore e cila duhet të respektohet. Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme janë nga radhët e LDK-së dhe mendoj se duhet t'iu bëhet kërkesë për shtimin e numrit të policëve sepse me ligj duhet të jenë 91 zyrtar policor ndërsa aktualisht janë 14 më pak, dhe nuk di çka presin që nuk e parashtrajnë një kërkesë të tillë sepse kjo është në dobi të qytetarëve. Po ashtu në fillim të informatës thuhet se ka disa raste të intervenimeve, konkretisht fjala është për drejtorin e DSHPMSh z.Faik Muçiçi i cili thotë se në katër mujorin e parë të vitit 2016 kemi 118 raste dhe krahasuar me vitin e kaluar kemi 61 raste më shumë, pra vërehet një ngritje e madhe, dhe tani unë dua t'ju them juve kolegë, që pas kësaj seance ne mund të shkojmë tek stacioni ku do të vërejmë bllokime të trotuareve nga automjetet, nga taksitë ilegal sikurse që do të

vërehen kërkesa dhe ankesa të shumta për prerësit ilegal të pyjeve gjë për të cilën mendoj se është shumë emergjente, në anën tjetër kemi institucionet, kemi policinë etj, andaj kjo mendoj se nuk arsyetohet. Në këtë informatë janë edhe disa informacione të cilat ne këshilltarët e Kuvendit nuk i kemi, një ndër ato është siguria në shkolla. Po e përsëris që këto informata është mirë t'i kemi ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës në mënyrë që të mos lexojmë të njëjtat në portale të ndryshme, qoftë për sigurinë në shkolla, qoftë për rastet e integriteteve apo kthimet e qytetarëve nga diaspora gjë për të cilën ne si Kuvend asnjëherë nuk jemi informuar për numrin e të ri-atëdhësuarve, cilat janë masat e ndërmarra nga Qeveria për ata njerëz të cilët vërtetë janë në një gjendje të rëndë dhe mendoj se duhet të kemi parasysh këto raste. Mandej konsideroj se nuk duhet anashkaluar edhe rasti i ndodhur më 28 nëntor në fshatin Dumosh ku vritet një qytetarë dhe ende nuk ka kurrfarë informate rreth atij rasti i cili mendoj se ka shkaktuar një pasiguri tek qytetarët dhe mendoj se nuk është mirë nga ne si Kuvend komunal që kjo të kalohet në heshtje për arsye se është interes i joni dhe kërkesë e qytetarëve. Marrë në përgjithësi vërtetë ka shumë gjëra të cilat të bënë të jesh pesimist për arsye se në informatë thuhet se nuk kemi polic më shumë, dhe dëshiroj të potencoj edhe një herë se kjo është arsyeja që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kërkojmë raport nga Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë, për arsye se nuk është mirë që qytetarët të pësojnë në mungesë të personelit edhe pse me ligj është e paraparë numër i caktuar ndërsa në Podujevë ka 14 zyrtar policor më pak, krejt kjo shkon në dëm të qytetarëve dhe ashtu siç u tha edhe nga parafolësit kemi rastin e djeshëm në shkollën e mesme teknike ku plagoset nxënësi, nuk dëshiroj ta fajësoj askënd përderisa të kryhen hetimet përkatëse por një pjesë të fajit e kemi edhe ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës.

z.Kadri Avdiu, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës realisht ne edhe dje në KPF diskutuam, kjo është vetëm një informatë dhe në bazë të materialit që posedojmë unë e kam parë se Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka dhënë informacione për ndodhitë që kanë ndodh gjatë vitit të kaluar. Meqë po ndërlidhet me rastin e djeshëm ku janë plagosur dy nxënës të një shkolle në qytet, rast i cili për fat të keq ka ndodhur, por tani ne nuk mund të akuzojmë procesin mësimorë apo shkollën sepse ata nxënës kanë qenë në orë të mësimit ndërsa plumbi ka ardhur nga jashtë, pra duhet të bëhemi të sqartë, mirëpo unë mendoj se nga ky Kuvend duhet të bëhet një kërkesë unanime që të kërkohet nga organet e policisë dhe drejtësisë që ajo ngjarje të hetohet dhe të vërtetohet se kush shtiu plumb i cili në bazë të vrimës duket se ka qenë i drejtpërdrejt por janë ekspertët ata të cilët i vendosin këto çështje, mirëpo duhet të kërkohet që ky rast të zbardhet dhe të merren masat përkatëse ndaj këtij rasti sepse raste të ngjashme mund të përsëriten edhe në të ardhmen, dhashtë Zoti të mos ndodhin më raste të tjera askund në Kosovë që një fëmijë – nxënës i pafajshëm duke u munduar të merr dije në shkollë, të merr plagosje apo vdekje në klasë, gjë e cila do të ishte shumë tragjike. Sa i përket KKS-së, unë mendoj se ne duhet presim deri sa të kryhen punët tjera rreth rastit në fjalë, dhe mendoj se në të ardhmen duhet të zgjerohet rrjeti, e them këtë sepse ndoshta nganjëherë po bëhem i tepërt ku po e them se në kohët e kaluara, para luftës, siguria në shkolla dhe afër shkollave është mbajtur me njerëz civil, kur nuk kemi pas organe, nuk kemi pas polic, as ushtarë, por kemi pas vetëm vullnetarë pa pagesë me të cilët është ndërprerë huliganizmi në shkolla dhe afër tyre, i kemi mbrojtur shkollat tona madje në një kohë kur ato kanë qenë shtëpi – shkolla, e lëre më sot që kemi organe të drejtësisë dhe ka raste që iu iket këtyre organeve, ndërsa ne si institucione, qoftë ne si Kuvend, qoftë Kryetari i Komunës, qoftë Qeveria, qoftë edhe Presidenti, duhet të bëjmë presion më tepër që mos ndodhin raste të tilla me rininë tonë për të cilën jemi në dijeni se është më e pastërta në regjion, dhe ne duhet të bëjmë çmos ta ruajmë atë, Po ashtu konsideroj se KKS por edhe Policia mund të luajnë një rol të bashkëpunimit më të madh me qytetarë. Sa i përket asaj që u cek nga parafolësit rreth numrit të

policëve në Stacionin e Policisë në Podujevë, konsideroj se nuk është në kompetencë të KKSBS-së, as këtij Kuvendi por është kompetencë e nivelit qendrorë, por unë besoj se nuk mund të jetë arsyetim që nuk ka numër të mjaftueshëm të policëve sa i përket vjedhjeve, lëshimeve apo dobësive në krahasim me vitet paraprake, sepse jemi në dijeni se në vitin 2014 nuk ka pasur asnjë vrasje, që për ne ka qenë një fakt i mirë, dhe ky numër i policëve ka qenë, mirëpo asnjë vit nuk është i njëjtë, mirëpo nuk guxojmë të mendojmë që nëse në këtë vit nuk ka pasur vrasje, në vitin e ardhshëm të rrimë të qetë sepse nuk do të ndodh asgjë. Me këtë dua të them që të gjithë duhet të jemi të kujdesshëm në mbështetje të sigurisë së vendit ngase në qoftë se kemi një siguri më të mirë në nivel Komune, atëherë del që ne jemi mirë. Ajo që mua më dhemb më së shumti është djegia e pyjeve e që ka filluar edhe në këtë pranverë të hershme, bëhen thirrje për intervenim në organet përkatëse si në Polici, në Shërbimin e Zjarrfikjes etj, dhe nga ana e tyre shpeshherë bëhen pyetje të gjata dhe ndoshta të tepërta që marrin kohë sikur të jesh para gjykatës, pra konsideroj se është dëm i madh që 77 hektar të digjen dhe shkatërrohen, të dhëna që janë në këtë informatë, e pastaj të mos flasim për prerje ilegale e gjëra tjera, por ne duhet të mundohemi të gjithë bashkërisht t'i shtyjmë gjërat nga pozitivja, e jo nga negativja.

z.Bahri Selimi, theksoi, dua të ndërlidhem me informatën e KKSBS-së, në fakt ne kronologjikisht jemi mësuar që sa herë që sjellën informata të tilla përfshihen vetëm statistika, gjë të cilën e vërejta edhe në këtë informatë e cila është paksa voluminoze dhe përfshihen statistika e që besoj se për neve këshilltarët e Kuvendit nuk qon shumë peshë të merremi me statistika, shembull, nëse në vitin e kaluar kanë ndodh X vjedhje ndërsa në këtë vit kanë ndodh më pak, dhe tani të krenohen me këtë, mirëpo unë mendoj se e mira do të ishte që ne të merremi me atë se si t'i ndalim ato, gjë të cilën askund nuk e vërejta se çka duhet të ndërmerret nga KKSBS dhe Policia e Kosovës që ato vjedhje të ndalen në tërësi edhe pse ndoshta krejt nuk mund të ndalen, pra mungon ajo se si të minimizohen rastet e vjedhjeve dhe rastet tjera të cilat i cekën nga parafolësit që kanë ndodhur në 24 orët e fundit, për të cilat edhe Grupi i LVV-së iu shprehim ngushëllimet atyre familjeve, raste të cilat vërtetë janë shqetësuese, mirëpo raste të tilla ndodhin në përgjithësi edhe në Komunitat tjera. Dëgjova se është bërë një kërkesë për raportim të Komandantit të Stacionit të Policisë para këtij Kuvendi, besoj se do të ishte shumë e mirëseardhur sepse ka çka të bisedohet edhe për KKSBS-në edhe për Policinë e cila siç dëgjova deri tani paska numër më të vogël se sa që është e paraparë, po ashtu do t'i thoja Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë se edhe policët të cilët po e mirëmbajnë sigurinë afër shkollave, në bazë të informatave, pak a shumë po e keqpërdorin detyrën e tyre, dua të them se fjala është policët të cilët sillen rreth shkollave të cilët janë në rroba civile për shkak të strategjive të tyre policore, mirëpo si do që të jetë keqpërdorimi i detyrës zyrtare edhe tek policia është shumë evident, prandaj mendoj se do të ishte mirë që për këto gjëra të merremi edhe me Komandantin e Stacionit të Policisë në Podujevë, dhe do të ishte mirë që ai të vie në këtë Kuvend dhe ta bëjë një raportim të gjendjes së sigurisë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se raportin për gjendjen e sigurisë si raport e kemi dhe nuk e shoh të arsyeshme të diskutohet për këtë, mirëpo ne si Kuvend është mirë të dalim me propozime se çka po kërkojmë për sigurinë e qytetarëve, shembull për problemin e sigurisë në shkolla, problemin e pyjeve, sigurinë në trafik, sigurinë ndaj ekstremizmit fetar, sigurinë kundër krimit të organizuar, vjedhjeve etj, fusha këto të cilat praktikisht janë si probleme të cilat mund të shfaqen këtu. Ne edhe dje në KPF diskutuam për raste të ndryshme, mendoj se gjendja mund të ndryshoj brenda ore apo brenda minute siç ishte rasti i djeshëm në shkollë i cili ka mund të përfundoj me fatalitet për ato familje, por i gëzohem faktit që nuk është bërë më keq. Ne si Kuvend mund të nxjerrim disa propozime sepse askush nuk na e ndalon të ndihmojmë, të kontribuojmë me vendime dhe propozime tona si dhe t'i japim përkrahje gjendjes së sigurisë tonë sepse

Komandanti i Stacionit të Policisë nuk ka çfarë të bëjë vetëm, Mendoj se Kuvendi i Komunës është mirë të merr vendim, meqë parametrat ligjor e lejojnë, me të cilin të bëhet kërkesë për shtimin e numrit të policëve në krahasim me hapësirën gjeografike që lejohet me ligj. Çështje tjetër mund të kërkojmë krijim të kushteve më të mira për zjarrfikës në funksion të ruajtjes së pyjeve, e them këtë sepse të gjithë kërkojmë të ruhen pyjet ndërsa që 15 vite kemi një automjet të zjarrfikësve që i është sjellë Komunës. Departamenti i emergjencave në nivel vendi por edhe ne si Komunë duhet të ndajmë buxhet për t'i ruajtur pyjet tona. Pastaj tek siguria në shkollë, vendosja e kamerave, që e përmendi edhe kolegu z.Fidan Rekaliu, absolutisht mendoj se vendosja e kamerave duhet të jenë prioritet qoftë edhe në hyrje – daljet e qytetit ngase kemi parë në media që janë bërë arrestime në magjistrale me nga 200 kg lëndë narkotike, andaj duhet të jenë prioritet vendosja e kamerave në shkollë dhe afër tyre, pastaj në hyrje – daljet e qytetit dhe në rrugët kryesore të qytetit. Mandej nga Drejtoria e Arsimit duhet të ketë kampanja kundër armëmbajtjeve pa leje, vetëdijesim kundër narkomanisë etj, dhe ne si Kuvend duhet t'i nxjerrim në formë të propozimeve dhe rekomandimeve dhe për çështje tjera që ne mendojmë se i kontribuojmë gjendjes së sigurisë që e kemi. Pra e potencova këtë sepse ky raport nuk votohet, por votohet plani i punës i KKS-së, i cili ekziston dhe për të cilin ne vetëm presim të zbatohet.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, dëshiroj të përfundojmë me këtë pikë. Konsideroj se u diskutua mjaftë dhe pati diskutime shumë të arsyeshme rreth kësaj pike të rendit të ditës për çka ju falënderoj të gjithëve për kontributin e juaj rreth kësaj pike. Ne si Kuvend do të kërkojmë në formë të shkruar që Komandanti i Stacionit të Policisë të paraqesë një informatë për gjendjen e sigurisë në Komunë. Vërtetë jemi të shqetësuar për dy rastet e fundit që kanë ndodhur dhe shpresojmë se plagët e marra nuk do të kenë pasoja në shëndetin e tyre. Po ashtu ne si Kuvend i Komunës së Podujevës, apelojmë tek qytetarët e Komunës së Podujevës ndaj të shtënave me armë zjarri në ahengje dhe raste tjera të ndryshme, dhe njëkohësisht kërkojmë që organet përkatëse të marrin masa ligjore ndaj tyre. Mendoj se me disa vërejtje mund ta përfundojmë këtë pikë, dhe njëkohësisht e hedhim në votim planin e punës për vitin 2017 të propozuar nga KKS. Ne si Kuvend kemi të drejtë të paraqesim edhe tema tjera gjatë vitit, andaj e hedh në votim propozim planin e punës së KKS-së për vitin 2017.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim Plan i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017

6. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës dhe pronës publike rrugë-lokale në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju njoftoj se këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe për të njëjtën i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, mirëpo si do që të jetë, unë e hapi debatin.

z.Bahri Selimi, theksoi, nuk e besoj se do të ishte e drejtë dhe fer të kalohej një pikë për të cilën unë mendoj se është goxha e ndjeshme duke marrë për bazë furnizimin e me rrymë që ka Komuna e Podujevës. Ne shumë herë kemi bërë ankesa, duke u nisë prej Kryetarit të Komunës i cili ka kërkuar të mos ndalet rryma në territorin e Komunës së Podujevës, për shkak se në këtë pjesë

po ka ndërprerje të mëdha të rrymës elektrike, mandej ka pas edhe shumë ankesa tjera rreth ndërprerjes së rrymës, pastaj ka pasur edhe shkrime mediatike të cilat kanë kritikuar ndërprerjen e rrymës në Komunën e Podujevës, ndërsa ne sot ta kalojmë si pikë dhe t'jua japim KEDS-sit 10 parcela në shfrytëzim pa kurrfarë kompensimi, besoj se nuk është në rregull dhe nuk është e drejtë sepse, në parim, nëse unë do ta kisha një fije përgjegjësie në këtë Komunë, këto prona në këtë formë siç janë sjellë rreth 30 m² nuk do t'jua kisha dhënë fare, vlen të ceket se edhe në të kaluarën ne kemi dhënë 3-4 prona në shfrytëzim me arsyetim të KEDS-it se po bëhen investime në energjinë elektrike në Komunën e Podujevës, dhe tani janë propozuar edhe 10 prona tjera me arsyetim të njëjtë. Nuk jam në dijeni se a janë bërë kontrole se a janë ngritur trafostacione apo jo, e them këtë sepse bazuar në atë, gjendja me rrymë në Komunën e Podujevës veç po keqësohet, andaj mendoj se ndoshta këtë mirësi që ne po e bëjmë për KEDS-in e cila sipas mendimit tim nuk meriton t'i japim parcela në shfrytëzim pa kompensim, për shkak se ajo tash më është një ndërmarrje private e cila gjithherë me ndërtimin e atyre trafostacioneve që ne po ja japim pa kompensim, po gjeneron mjete financiare – të hyra, kurse të mirën që ja bëjmë ne, ajo e kthen me ndërprerje të energjisë elektrike, madje ka raste që në Komunën e Podujevës është ndërprerë energjia elektrike 8 orë duke u arsyetuar se ka defekte, mirëpo propozimi im konkret është, për këto parcela që janë propozuar t'i jepen në shfrytëzim kësaj kompanie e cila është e sektorit privat por jo e sektorit publik sepse po të ishte publike nuk e besoj se do ta kisha diskutuar këtë çështje, të kërkohet kompensim sepse edhe ata neve po na kërkojnë kompensim për rrymën që po e harxhojmë, por edhe nga mjetet gjenerohen prej këtyre trafostacioneve. Prandaj kërkesë e imja personale është që KEDS-it t'i drejtohem me një kërkesë nga këtu që të jenë pak më syçelë dhe më vigjilent kur kemi të bëjmë me ndërprerjen e rrymës që mos ta ndërpresin pa ndonjë arsye të madhe, sepse nëse dikur është thënë se ndërprerjet e rrymës po ndodhin si shkak i mos pagesës, tani nuk mund të thuhet më e njëjta gjë sepse unë shoh qytetarë të shumtë të cilit presin në radhë për t'i kryer pagesat, dhe përderisa ne presim në radhë për të paguar rrymën, duhet të kemi furnizim të rregullt me rrymë. Pra për fund, të paktën këto parcela nuk meritojnë t'i marrin.

z.Kadri Avdiu, theksoi, ndoshta parafolësi ka të drejtë në atë që e thotë, por ne në mbledhjen e KPF-së e kemi diskutuar këtë çështje dhe të paktën ndoshta nuk do të duhej të kalonte një pikë e tillë pa u diskutuar në Kuvend, mirëpo atë që e tha parafolësi z.Bahri Selimi, ajo gjendje nuk mund të ndryshoj sepse nuk është fjala për ndërprerje të energjisë por kemi të bëjmë me shtimin e numrit të trafostacioneve, madje po të shtohen edhe 200 trafo të tilla, nëse ndërprehet rryma nga qendra, nuk do të mund ta ndryshoj orarin e ndërprerjes së rrymës, "pa" edhe "me". Ne jemi në dijeni se ajo kompani është private, por problemi është se në territorin e Komunës së Podujevës është një rrymë shumë e dobët që sillet nga 150 v, 160 v ndoshta mund të shkoj ndonjëherë deri në 180, dhe shtimi i trafostacioneve e shton atë në 220 v që pretendohet të bëhet. Unë nuk jam ndonjë elektrikist që ta njohë këtë fushë, por kjo gjendje veç shihet sepse kemi aparate të ndryshme nëpër shtëpitë tona ku vërehet se në mëngjes nuk funksionon asgjë, në mbrëmje po ashtu, dhe krejt kjo si pasoj e rrymës së dobët që është 150 v dhe që nuk funksionon dhe po ashtu harxhon më shumë, ndërsa unë e them se duke marrë parasysh se është interes i drejtpërdrejtë që të kemi rrymë stabile tek qytetarët, ne duhet ta mbështetim këtë dhe nuk kemi për çka të dalim kundër sepse është interes i qytetarëve, po të mos ishte interes i qytetarëve ne do të mund të caktonim një tarifë, mirëpo ne duhet të mos jemi pengesë që të paktën në të ardhmen ta kemi një rrymë stabile, andaj për këtë arsye edhe e mbështesë këtë propozim vendim.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, unë mendoj se dhënia e këtyre pronave publike në shfrytëzim, nuk është e arsyeshme pa një kontratë apo marrëveshje me atë kompani, për arsye se siç jemi në dijeni nga shumë vende, këtu nuk bëhen investime. Buxheti i KEDS është mbi dhjetë herë më i

madh se sa buxheti i Komunës së Podujevës, pra Komuna e Podujevës po i falë pronë publike të fortit, kurse ata nuk po bëjnë investime të duhura edhe pse e kanë me kontratë, prandaj unë kërkoj që Komuna e Podujevës ta kushtëzon KEDS-in që ata të bëjnë investime sa më shumë me qëllim që mos të jetë rryma e dobët ashtu siç e ceku kolegu parafolës, sepse ne kemi shumë pasoja në pajisjet tona si shkak i rrymës së dobët si dhe shpenzohet shumë më shumë energji elektrike dhe natyrisht se faturat janë më të larta aty ku rryma është më e dobët, shembull, në vend që një mjet i energjisë elektrike të punoj 1 apo 2 orë, atij me rrymë të dobët i duhet të punoj 5 apo 6 orë.

Pra investime të tilla nuk janë duke ndodhur nga KEDS edhe pse janë të obliguar me kontratë, kështu që ne duhet të jemi të vëmendshëm, jo të kërkojmë diçka prej tyre, por të kërkojmë investime në ato vende perkatëse.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, sa i përket dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim kompanisë KEDS, ne e kemi diskutuar edhe më parë dhe i kemi dhënë arsyet pse duhet të jepen në shfrytëzim këto prona. Unë në një formë pajtohem me parafolësit që pronën publike nuk është mirë t'iu jepet atyre pa një kompensim, por megjithatë humbësit e vetëm nga mos dhënia eventuale e pronës në shfrytëzim për KEDS, janë ata qytetarë të cilët kanë nevojë për rrjet më të mirë të energjisë elektrike. Për gjërat tjera rreth KEDS-it ne jemi në dijeni të gjithë, dhe në këtë aspekt edhe unë jam një prej atyre që nuk pajtohem se si është shitur – privatizuar, sa ka fitim dhe çfarë shërbimi ofron, por nuk jam një prej atyre që qytetarët të mbesin pa rrjet të mirë dhe të njëjtit të dëmtohen si shkak i mos marrjes së një vendimi nga ana jonë si Kuvend, për dhënien në shfrytëzim parcelat perkatëse për vendosjen e trafostacioneve të nevojshëm për t'u pajisur ata qytetarë me energji elektrike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se u zgjat kjo temë rreth dhënies së pronave komunale Kompanisë KEDS. Asnjëri prej nesh nuk jemi të kënaqur me shërbimet e KEDS-it, madje jo vetëm në Komunën tonë, por unë ekskluzivisht po foli vetëm për Komunën e Podujevës. Ka qenë një propozim i mëparshëm që prona të tilla t'i jepen KEDS-it me kompensim në shumë 0.5 deri në 0.7 cent për m² vetëm si element që të dihet se është apo jo pronë publike, propozim i cili është miratuar, mirëpo për të njëjtat është sjellë rekomandimi tjetër pas 2-3 muajve që ai vendim të shfuqizohet, dhe i njëjti është miratuar edhe nga parafolësi z.Nexhat Llumnica, i cili tani sërish kërkon ta fuqizoj, pra kjo është e vërteta dhe mund të vërtetohet edhe në procesverbale. Pra jemi takuar dhe kemi vendos që shuma prej 0.5 deri 0.7 cent për m² të caktohet për dhënien e pronave të tilla në shfrytëzim për trafostacione, dhe 10 të tilla bëjnë rreth 90 m² e që i bie më pak se 1 € për të gjitha këto, pra kostoja e atij çmimi që është marr vendim, i bie 0.50 cent për këto 10 trafostacione, që do të thotë me kosto 50 cent në muaj ndërsa rreth 5 € në vit si e hyrë komunale, çmim ky i caktuar nga ne dhe është marrë vendim për këtë, ndërsa kur është sjellë propozimi për shfuqizim ju zotëri Llumnica e keni votuar për ta shfuqizuar atë vendim e që mendoj se e kemi banalizuar vendimin tonë. Mendoj se edhe Kryesuesi i Kuvendit për disa tema është mirë të jap replika. Nuk po dëshiroj ta personalizoj këtë temë, mirëpo mu në fshatin prej nga vie z.Nexhat Llumnica është hy rrjeti i ri i energjisë elektrike, ndërsa tek Lagjja ime por as tek Lagja e z.Kadri Avdiut ende nuk është sjellë, dhe unë jam gëzuar kur janë vendosur shtyllat e betonit dhe kabllot janë futur nën dhe, ashtu siç i jam gëzuar vendosjes së transformatorit të ri në atë pjesë edhe pse tek fshati im ende nuk është sjellë sepse nuk është përfshirë në projekt e që mendoj se është mirë drejtori i Drejtorisë perkatëse të kërkoj të shtrihet rrjeti në tërë territorin e Komunës së Podujevës, mirëpo konsideroj që nëse ne si Kuvend e bllokojmë një propozim të tillë nuk do të furnizohemi mjaftueshëm me energji elektrike. Çështja tjetër që dua të theksoi është se që atëherë unë kam propozuar që pronat perkatëse të jepen në shfrytëzim me kompensim, dhe pa dëshirën time është shfuqizuar ai vendim, kurse tani po kërkohet sërish të fuqizohet, andaj meqë kemi vepruar në të

kaluarën në këtë formë, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, për hir të shtrirjes së rrjetit të ri dhe atyre qytetarëve nuk po mund dalim kundër këtij propozim vendimi. Sa vërejta nga diskutimet shoh se u ngritën tensione se kush po e përkrah më shumë e kush më pak këtë propozim, madje duke ngritur edhe çështje rreth KEDS-it se a është privat apo është publik, ndërsa ne jemi në dijeni se ligji e ka lejuar si furnitor të vetëm që e ka të drejtën e shfrytëzimit, pra ka qenë me ligj dhe është privatizuar, kurse ne duhet t'i mbrojmë qytetarët tanë, shembull, keni vërejtur shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrike në pjesën e Batllavës, pjesë në të cilën kanë elektorat të gjitha subjektet, dhe tani të votojmë ne një vendim me të cilin do t'i hiqim ato shtylla dhe trafostacione, sigurisht se ata banorë do të thonin, shiko atë të drejtë e kanë këshilltarët e Kuvendit dhe atë e kanë bërë duke na lënë keq. Sërish e përsërisë që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështetim shtrirjen e rrjetit të ri dhe vendosjen e atyre transformatorëve për arsye të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike për banorët e Komunës së Podujevës.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, i nderuar këshilltar z.Rafet Llapashtica, besoj se më keni keqkuptuar edhe atëherë kur është bërë ajo falje e pronës publike për KEDS, ashtu siç më keni keqkuptuar edhe tani. Që atëherë kam deklaruar se KEDS ka mbi 280 milion euro buxhet dhe nuk kemi nevojë të falim pronë pa një marrëveshje konkrete, ndërsa kur është votuar që të falet ajo pronë unë kam votuar kundër, gjë e cila mund të vërtetohet edhe në procesverbal, megjithatë unë besoj se ju nuk e keni shikuar procesverbalin por vetëm e potencove ashtu, duke thënë se ai vendim është marrë me shumicë të votave, e që pajtohem se është votuar ashtu me shumicë, por asnjëherë nuk pajtohem që KEDS-it t'i falim pronë publike pa një marrëveshje konkrete sepse ajo kompani ka një buxhet shumë të mirë dhe kanë obligim kontraktues për t'i kryer këto punë, pa marrë parasysh se për çfarë prone bëhet fjalë private apo publike, KEDS duhet të kryejnë kontratën e tyre në bazë të asaj që është nënshkruar me Qeverinë e vendit dhe si është shitur, andaj tani përgjegjësitë e juaja se çka keni bërë me Qeveri, mos u mundoni të anashkaloni këtu në këtë Kuvend, ngase nuk mund ta anashkaloni këtë.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ajo që është me rëndësi dhe që duhet ta dimë të gjithë është se furnizimi me energji elektrike me një nivel të lartë është në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës, për shkak se siç jemi në dijeni të gjithë, ne si Komunë gjithëherë kemi pasur telashe me energjinë elektrike sepse tensioni ka qenë i ultë, pastaj si pasoj e mungesës së trafëve të vendosura në lokalitete të ndryshme rryma ka qenë shumë e ultë nëpër shtëpitë tona gjë që ka shkaktuar edhe prishjen e shumë makinerive – pajisjeve të ekonomive familjare dhe në ndërmarrje të ndryshme. Ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për dhënien e pjesëve përkatëse të parcelave përkatëse në shfrytëzim kompanisë KEDS sepse konsiderojmë se qytetarëve të Komunës së Podujevës po ju krijojmë kushte më të mira për jetesë, prandaj nuk ka ndonjë filozofi këtu sepse këto prona po i japim në shfrytëzim për bashkëqytetarët tanë, jo për dikë tjetër.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, unë po besoj se pronën komunale nuk është askush këtu i interesuar të jap pa ndonjë kompensim, por vetëm duhet ta kemi për bazë dëmtimin e qytetarëve si pasojë e rrjetit të dobët që është aktualisht, dhe në qoftë se ne nuk e lejojmë KEDS-in t'i vendos trafostacionet në pronë publike, atëherë kush pëson nga kjo, vetëm këtë duhet ta kemi parasysh. Ndërsa sa i përket çështjes së privatizimit të KEDS-it mendoj se janë organet tjera ato të cilat duhet ta shqyrtojnë atë.

z.Bahri Selimi, theksoi, ne natyrisht se jemi persona politik dhe duhet të merremi nga pak me politikë, por jo në të gjitha rastet siç është kjo që tani po diskutojmë dhe e cila pothuajse e tëra kalon në çështje politike, Mendoj se nuk është fer të thuhet se është interes i qytetarëve dhe të thuhet pastaj dikush e përkrah i dikush jo. Unë isha shumë i kthjellët kur e thash që interesi i

qytetarëve është para se ta japim këtë pronë në shfrytëzim dhe para se të rregullohet kjo çështje e pronës, është të kemi rrymë të mjaftueshme dhe kjo është në rend të parë interes i qytetarëve, ndërsa unë mendoj se mandej vijnë ato forcimet dhe përforsimet e energjisë elektrike. Normal që kundër interesit të qytetarëve nuk jemi asnjëri nga ne, sepse fundja jemi të deleguarit e tyre këtu në këtë Kuvend, mirëpo metoda dhe mënyra se si ne po i menaxhojmë pronat publike mendoj se është shumë në kundërshtim me atë çfarë do të ishte në të vërtetë, që ato t'i jepen një kompanie private, gjë të cilën e kam cek disa herë. Unë nuk besoj se pësojnë qytetarët nëse nuk jepen këto prona në shfrytëzim për KEDS-in dhe mendoj se krejt kjo është në favor të kësaj kompanie, e them këtë sepse KEDS ka kontratë dhe është i obliguar ta rregulloj gjendjen e rrymës duke marrë për bazë faktin që kjo kompani gjeneron – merr mjete financiare nga ne, pra dua të them se ajo kompani ka për obligim përmirësimin e rrjetit dhe furnizimin me energji elektrike, pavarësisht se ju japim prona apo jo. Ne në parim nuk jemi kundër dhënies së pronave në shfrytëzim por jemi kundër faljes së pronave ngase kjo është një falje e pronës për 40 vite. Sa do pak të ishte një shumë e caktuar, do të dihej se ajo pronë është në pronësi dhe menaxhim të Komunës.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), theksoi, më duket se kjo çështje u zgjat paksa pa pasur nevojë aq shumë. Sa i përket asaj që parafolësi e tha se dhënia e pronave publike në shfrytëzim, është në kundërshtim me ligjin, unë ja sqaroj atij se nëse e lexon ligjin përkatës, neni 10.1.5 e parasheh dhënien e pronës me kompensim dhe pa kompensim, pra ato prona nuk jepen pa mbështetje ligjore. Gjithashtu ju njoftoj që para se të përgatiti këtë propozim vendim për ta proceduar në Kuvendin e Komunës, unë kam hulumtuar lidhur me këtë çështje dhe kam hasur në një dokument që Komuna e Prishtinës tash së fundmi ka dhënë një pronë të tillë dhe në atë dokument thuhet me kompensim, mirëpo para dy ditëve kemi pasur takim me drejtorin e KEDS-it së bashku edhe me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ku unë e kam paraqitur çështjen e kompensimit, konkretisht ju kam shtruar pyetje përse nga ne kërkoni prona pa kompensim ndërsa komuna tjera këtë e bëjnë me kompensim, përgjigja ka qenë, më sjell një dëshmi që KEDS ka paguar ndokujt kompensim për këtë çështje duke përfshirë edhe Komunën e Prishtinës, dhe po ashtu e ceku një fakt ku tha se kompania KEDS është në gjendje edhe të blejë pronë private, por për pronë publike nuk japim asnjë cent. Gjithashtu jua rikujtoj se rreth 2 vite më parë ky Kuvend ka marrë vendim për një gjë të tillë duke caktuar edhe shumën e kompensimit, mirëpo KEDS nuk e ka pranuar një vendim të tillë, por për hir të interesit të qytetarëve sërish i kemi sjellë në Kuvend dhe kemi vendosur që ato pjesë të parcelave t'jua japim pa kompensim.

Gjithashtu në këtë propozim vendimin është lëshuar një gabim teknik, dhe atë, në nenin 1 pika IV.2 ku ceket Zona kadastrale Gllmanik, duhet të jetë Zona kadastrale Katunisht.

z.Haki Rudari, theksoi, sigurisht që ne jemi duke diskutuar për Komunën e Podujevës, dhe unë ju them se ligji nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 6 pika 1 thotë, dhënia e pronës së paluajtshme e komunës në shfrytëzim afatgjatë duhet të bazohet në këto kritere; ato janë, duhet të jetë i bazuar me Planin Zhvillimor Komunal, pastaj kritere mjedisore, plane urbanistike etj, por nën 4 thotë, të ardhurat që realizohen nga dhënia e pronës së paluajtshme në shfrytëzim konsiderohen para publike, andaj Vetëvendosja që nga fillimi nuk ka qenë kundër investimeve, por ka qenë kundër dhënie së pronës në shfrytëzim pa kompensim. Po ashtu nga disa parafolës u tha që nëse nuk miratohet ky propozim vendim, humbësit do të jenë qytetarët, e që ne nuk jemi që të humbin qytetarët, përkundrazi ne jemi për të fituar qytetarët dhe për të fituar Komuna. Më parë por edhe sot u tha se nëse caktojmë shumë për kompensim kompania KEDS tërhiqet, unë e them se nuk ka të drejtë të tërhiqet ajo kompani sepse i ka obligimet nga privatizimi i saj, nuk ka të drejtë të bëjë çfarë të dojë këtu, prandaj duhet

të kemi kujdes me pronën e paluajtshme, por të njëjtën kohë të gjithë jemi për interes të qytetarëve dhe askush nuk është që të humbin qytetarët, përkundrazi jemi për të fituar qytetarët, për të fituar Komuna, ndërsa KEDS është kompani private dhe e ka interesin e vetë.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, edhe pse nuk kam dëshirë të merrem me lokalitete dhe vendbanime të caktuara, ju tregoj për një lokalitet i cili shtrihet në vendlindjen time ku janë rreth 12 shtëpi të cilat që nga paslufta kanë probleme të pa tejkalueshme me furnizimin me energji elektrike, andaj ne duhet t'i kemi për bazë ata qytetarë dhe të marrim vendim në favor të tyre.

Kryesues i Kuvendit, e hedh në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, asnjë votë kundër dhe 3 vota të përmbajtura u miratua propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës dhe pronës publike rrugë-lokale në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, duke përfshirë edhe korrigjimin e pikës IV.2 të nenit 1.

7. Ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Komunitete

z.Mehmet Gashi, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se propozimi i këtij vendimi është mjaft i qartë, dhe ky plotësim ndryshim i përbërjes së këtij Komiteti është bërë pas diskutimeve me shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, andaj unë e hapi debatin nëse ka këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për ndryshimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete.

8. Të ndryshme

z.Flakron Gashi, theksoi, unë si zyrtar publik i zgjedhur me votën qytetare, në seancën e kaluar kam bërë një premtim publik dhe kam dhënë një deklaratë publike, kam thënë kështu; ndër vite në Komunën e Podujevës përderisa është qeverisur nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në arsimin parafillor dhe të mesëm kanë punuar qindra mësimdhënës të pakualifikuar. Reagimi i Nënkyetarit të Komunës z.Nexhmi Rudari dhe ish drejtor i Drejtorisë së Arsimit i asaj kohe, ka qenë se ndoshta bëhet fjalë për ndonjë punëtor teknik, dhe për ata nuk duhet të ketë kualifikim shtesë. Ja ky është dokumenti publik i cili është zyrtar sepse është miratuar nga kjo asamble komunale në legjislaturën e kaluar, dhe unë po e citoj; me kualifikim të mesëm të cilët punojnë në shkollat e mesme dhe fillore në Komunën e Podujevës janë 458 mësimdhënës dhe me kualifikim fillor janë 95 mësimdhënës. Kësisoj bazuar në këtë dokument publik të miratuar në mandatin e kaluar, në Komunën e Podujevës kanë punuar 553 mësimdhënës të pakualifikuar. Unë jam shumë i bindur se çdo qytetarë i këtij vendi ka nevojë për një pagë lineare, mirëpo realizimi i një të drejte duke shkelur të drejtën e tjetrit përbën në vete precedent penal dhe për këtë përgjegjës janë zyrtarët komunal të arsimit dhe qeverisja komunale e udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës në Komunën e Podujevës, të cilët e kanë lejuar këtë gjendje të mjerueshme dhe kësisoj sot në shkollat e mesme rezultati i përgjithshëm i notës mesatare kurrë nuk e arrinë 2.5, por sillet nga 2.24 deri në 2.37. Ta kthesh sistemin arsimor në Komunën e Podujevës në qendër për punë

sociale është e tmerrshme dhe kësisoj po e vrasim të ardhmen e të rinjve tanë. I nderuari Kryesues, unë kam bërë deklaratë publik që një kopje të këtij dokumenti do ta ketë Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari i cili do të doja të ishte prezent këtu por jua lë këtë dokument t'ia përcillni atij.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se ato që parafolësi i ceku mund të jenë gabime teknike sepse në materiale – dokumente të ndryshme mund të ndodh të lëshohen gabime të tilla teknike nga secili prej nesh, mirëpo si do që të jetë, ju keni bërë këto deklarime.

Fjala është për dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2011 – 2014

Nuk pati këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, *Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi këtë mbledhjen të përfunduar.*

Mbledhja përfundoi në orën 12;30

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-16867/17
Podujevë,
07 mars 2017**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**